



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Nr. Protokollit: 060/01-70394

Data: 14 Shtator 2026

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e VII-të rregullore për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 24.09.2026 (Enjte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 31.07.2026.
3. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 68/2026 për fillimin e procedurës për harmonizimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës, 2023-2031, sipas kërkesës së MMPH, me nr. prot. 3747-2/26, dt. 15.07.2026.
4. Shqyrtimi dhe miratimi buxhetit të Komunës së Pejës 2027-2029.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat Florin (Muharrem) Krasniqi, Venera (Mahir) Kelmendi, Bos Peter (William Mattjas), Arjeta (Mahir) Mala dhe Ramiz (Avdyl) Nikq, me qëllim të zgjerimit të rrugës dhe sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë si Interes Publik sipas PZHK-së.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit privat Luigj (Ilhami) Karagjija me qëllim të krijimit hapësirës për shërbim kulturor dhe rekreativ si Interes Publik sipas PZHK-së

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme private në pronësi të Hysnije (Alil) Jusaj, Ali (Ramë) Basha dhe Reliumd Group, me qëllim të realizimit të Interesit Publik: “Zgjerimi i rrugës si dhe Sigurimi i kushteve të nevojshme për funksionimin e bazës ushtarake në Bellopojë”, si Interes Publik sipas PZHK-së.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarit Rexhë (Avdi) Muriqi, me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë, si Interes Publik sipas PZHK-së.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit privat Shani (Sejfullah) Kasapi, me qëllim të realizimit të Interesit Publik: “Krijimi i hapësirave publike buzë Lumbardhit”, si Interes Publik sipas PZHK-së.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me me pronat e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat Skender (Tahir) Jusaj dhe Blerim (Gani) Pupovci, të cilat do të merren me qëllim të realizimit të Interesit Publik: “Shërbim kulturor dhe rekreativ-hapësirë e hapur publike”, si Interes Publik sipas PZHK-së.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2026.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSB-së për vitin 2026.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2026.
16. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për periudhën kohore, 21 Korrik 2026.
17. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për shpalljen e konkursit për Komitetet Konsultative:
1. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, 2. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit dhe 3. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
18. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e panelit përzgjedhës për Komitetet Konsultative.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

19. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.
20. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar. *(Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Mërkurën, me dt. 23 Shtator 2026).*
21. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

Br. Protokola: 01-060/01-41592

Data: . 14.septembra 2026. godine

Za: Članove Skupštine Opštine Peć

Poštovani članovi/članice,

Na osnovu člana 43, stav 43.1. Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 28, stav 1 Statuta br.01-2020 Opštine Peć i na osnovu člana 11, stav 1.2, člana 1.5 stav 1 Pravilnika o Radu br.02-2021 Skupštine Peć, Predsedavajući Skupštine vas:

POZIVA

Da učestvujete na VII redovnoj sednici Skupštine Opštine Peć za 2026. Godinu.

Sednica će se održati dana 24.09.2026 (četvrtak), u 10:00 časova, u sali Skupštine Opštine Peć.

Napomena: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda.
2. Razmatranje i usvajanje Zapisnika sa sednice Skupštine opštine Peć od 31.07.2026. godine.
3. Ponovno razmatranje Odluke br. 68/2026 o pokretanju postupka za usklađivanje i dopunu Zonalne karte Opštine Peć, 2023–2031, prema zahtevu MSPP-a, br. prot. 3747-2/26, od 15.07.2026. godine.
4. Razmatranje i usvajanje budžeta Opštine Peć za period 2027–2029.
5. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnostima u vlasništvu privatnih vlasnika Florina (Muharrem) Krasniqi, Venera (Mahir) Kelmendi, Bos Peter (William Mattjas), Arjete (Mahir) Mala i Ramiza (Avdyli) Nikqi, u cilju proširenja puta i obezbeđivanja neophodnih uslova za funkcionisanje vojnih baza u Belom Polju, kao javnog interesa prema ORP.
6. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu privatnog vlasnika Luigj (Ilham) Karagjija, u cilju stvaranja prostora za kulturne i rekreativne sadržaje, kao javnog interesa prema ORP.
7. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine za privatne nekretnine u vlasništvu Hysnije (Alil) Jusaj, Alija (Ramë) Basha i Reliumd Group, u cilju ostvarivanja javnog interesa: „Proširenje puta i obezbeđivanje neophodnih uslova za funkcionisanje vojne baze u Belom Polju“, kao javnog interesa prema ORP.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

8. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnostima u vlasništvu vlasnika Rexhë (Avdi) Muriqi, u cilju obezbeđivanja neophodnih uslova za funkcionisanje vojnih baza u Belom Polju, kao javnog interesa prema ORP.
9. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu privatnog vlasnika Shani (Sejfullah) Kasapi, u cilju ostvarivanja javnog interesa: „Stvaranje javnih prostora uz Bistricu“, kao javnog interesa prema ORP.
10. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnostima u vlasništvu privatnih vlasnika Skender (Tahir) Jusaj i Blerim (Gani) Pupovci, koje će biti uzete u cilju ostvarivanja javnog interesa: „Kulturni i rekreativni sadržaji – otvoreni javni prostor“, kao javnog interesa prema ORP.
11. Razmatranje i usvajanje predloga predsedavajućeg Skupštine opštine Peć za naknadu članovima Konsultativnih komiteta za 2026. godinu.
12. Razmatranje i usvajanje predloga Direktorata za administraciju i predsednika Opštine Peć za formiranje Komisije za izbor Lokalnih odbora u Opštini Peć.
13. Razmatranje i usvajanje predloga Direktorata za administraciju i predsednika Opštine Peć za formiranje Komisije za žalbe u vezi sa procesom izbora Lokalnih odbora u Opštini Peć.
14. Razmatranje i usvajanje predloga predsednika Opštine Peć za naknadu članovima OOBZ-a za 2026. godinu.
15. Razmatranje i usvajanje predloga Direktorata za administraciju i predsednika Opštine Peć za naknadu predsedavajućima Lokalnih odbora za 2026. godinu.
16. Razmatranje i preporučivanje Izveštaja o proceni štete prouzrokovane prirodnim i drugim nepogodama, za vremenski period od 21. jula 2026. godine.
17. Razmatranje i preporučivanje predloga predsedavajućeg Skupštine opštine za raspisivanje konkursa za Konsultativne komitete:
 - Konsultativni komitet za ekonomski razvoj,
 - Konsultativni komitet za zaštitu životne sredine i
 - Konsultativni komitet za osobe sa invaliditetom.
18. Razmatranje i preporučivanje predloga predsedavajućeg Skupštine opštine za izbor komisije za izbor Konsultativnih komiteta.
19. Razmatranje i preporučivanje informacije ODO o početku školske godine.
20. Pitanja i predlozi u vezi sa radom Opštine, koje su pokrenuli članovi, redosledom kojim su primljeni. (Dostaviti sekretaru najkasnije do srede, 23. septembra 2026. godine).
21. Pitanja pokrenuta na sednici od strane predsedavajućeg ili članova Skupštine.

PRESEDAVAJUĆI SKUPŠTINE,
G. Rexhep Kurtbogaj

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës Gazmend muhaxheri me date 08.06.2026, merr këtë:

KONKLUZION

I. I propozohet Kuvendit Komunal në Pejë që, në pajtim me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të parashtruar përmes aktit nr. 2356-2/26, datë 28.05.2026, të shqyrtojë dhe procedojë për rishqyrtim në Kuvendin Komunal të Pejës Vendimin nr. 24-2006 mbi fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e pjesshëm të Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023–2031, të miratuar në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Pejës më datë 29.04.2026.

Pas shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi Komunal i Pejës, propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e pjesshëm të Hartës Zonale të Komunës së Pejës do t'i përcillet për shqyrtim dhe miratim Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për planifikimin hapësinor.

II. Për zbatimin e këtij konkluzioni obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, e cila do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm, do të ndërmarrë veprimet procedurale përkatëse dhe do ta procedojë lëndën pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

ARSYETIM

Nga analiza e dokumentacionit planifikues në fuqi, krahasimi ndërmjet Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Pejës dhe Hartës Zonale të Komunës së Pejës, si dhe nga rishqyrtimi i kryer pas pranimit të aktit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 2356-2/26, datë 28.05.2026, është konstatuar se në pjesën grafike të Hartës Zonale janë përfshirë sipërfaqe dhe ngastra kadastrale që nuk janë paraparë me Planin Zhvillimor Komunal për destinimin përkatës.

Konkretisht, në Planin Zhvillimor Komunal janë përcaktuar vetëm dy zona të dedikuara për sport dhe rekreacion në parcela publike për të cilat Komuna e Pejës ka identifikuar interes publik për zhvillimin e kësaj kategorie. Megjithatë, në pjesën grafike të Hartës Zonale janë përfshirë edhe prona të tjera në territorin e Brestovikut, Majës së Zezë dhe në një pjesë të qytetit, të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Kjo mospërputhje ka ardhur si rezultat i lëshimeve teknike gjatë hartimit të pjesës grafike të Hartës Zonale dhe ka krijuar pengesa në zbatimin e dokumenteve planifikuese, duke kufizuar zhvillimin e pronave private dhe duke pamundësuar, në raste të caktuara, lëshimin e lejeve ndërtimore. Si pasojë, janë paraqitur ankesa administrative nga palët e prekura, të cilat në procedurën e shkallës së dytë janë vlerësuar si të bazuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Duke marrë parasysh se Komuna e Pejës nuk ka interes publik për shpronësimin e këtyre pronave dhe se vazhdimi i mbajtjes së tyre në këtë kategori cenon të drejtat pronësore dhe zhvillimore të qytetarëve, vlerësohet se korrigjimi i pjesës grafike të Hartës Zonale dhe largimi i ngastrave të përfshira gabimisht është i domosdoshëm për harmonizimin e plotë të dokumenteve planifikuese, eliminimin e lëshimeve teknike dhe juridike të identifikuara, si dhe për sigurimin e zbatimit të drejtë dhe të ligjshëm të planifikimit hapësinor në territorin e Komunës së Pejës.

Kjo mospërputhje ka ardhur si rezultat i lëshimeve teknike gjatë hartimit të pjesës grafike të Hartës Zonale dhe ka krijuar pengesa në zbatimin e dokumenteve planifikuese, duke kufizuar zhvillimin e pronave private dhe duke pamundësuar në raste të caktuara lëshimin e lejeve ndërtimore. Si pasojë, janë paraqitur ankesa administrative nga palët e prekura, të cilat në procedurë të shkallës së dytë janë vlerësuar si të bazuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Duke marrë parasysh se Komuna e Pejës nuk ka interes publik për shpronësimin e këtyre pronave dhe se vazhdimi i mbajtjes së tyre në këtë kategori cenon të drejtat pronësore dhe zhvillimore të qytetarëve, vlerësohet se largimi i tyre nga pjesa grafike e Hartës Zonale është i domosdoshëm për harmonizimin e plotë të dokumenteve planifikuese, eliminimin e lëshimeve teknike dhe juridike të identifikuara, si dhe për sigurimin e zbatimit të drejtë dhe të ligjshëm të planifikimit hapësinor në territorin e Komunës së Pejës.

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Pejë,
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor,
- Arhives.

KOMUNA E PEJËS

I.nr. 01 - 016/0139011 2026

Pejë, 08 Qershor 2026





KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTMENT FOR URBANISM AND ENVIRONMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ŽIVOTNE SREDINE

PËR/ZA/TO:	Gazmend Muhaxheri , Kryetarit të Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunes së Pejës
NGA/OD/FROM:	Dejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit Arta Nallbani – Drejtoreshë në DUMM
CC:	
REFERENCE:	08-350-38490
DATË/A:	08.06.2026
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Rishqyrtim i ligjshmërisë së aktit

Duke ju referuar shkresës zyrtare nr. 350/02-38490 datë 05.06.2026 të Kryetarit të Komunes së Pejës si dhe shkresës zyrtare të nr.2356-2/26 datës 28.05.2026 për vlersimin e ligjshmërisë së aktit, vendimi nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartes Zonale të Komunes së Pejës 2023-2031, Dejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit ka bërë rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit me një kronologji si vijon:

Në përgjigje të kërkesës së Kryetarit të Komunes së Pejës për shqyrtimin dhe analizimin e vlersimit të ligjshmërisë së aktit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor të datës 28.05.2026 me nr.protokolli 2356/26 Dejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit paraqet këtë kronologji të veprimeve:

Komuna e Pejës ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal sipas vendimit nr.83/2019 të datës 27.12.2019, si dhe Harten Zonale të Komunes së Pejës, e cila është aprovuar në datë 23.12.2023.

Pas miratimit të tyre Dejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit ka konstatuar se në disa zona ekzistojnë lëshime teknike dhe gabime në Harten Zonale. Këto pasaktësi janë evidentuar edhe gjatë zbatimit të dokumenteve planifikuese dhe vazhdojnë të paraqesin sfida në praktike.

Pas analizimit dhe krahasimit ndërmjet Planit Zhvillimor dhe Hartes Zonale Komunale nr.016-01/117212 datë 28.12.2023, është vërejtur nevoja për ndryshim dhe plotësim të pjesëshëm të Hartes Zonale të Komunes së Pejës , konkretisht në pjesën tekstuale dhe në pjesën grafike të saj. Ky lëshim ka



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTAMENT FOR URBANISM AND ENVIRONMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ŽIVOTNE SREDINE

rjedhur si pasoje e mos përfshirjes së saktë në pjesën grafike të Hartes nga eksperti i angazhuar i GIS-it.

Me këtë drejtim Dejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit ka inicuar procedur për përmisimin dhe eliminimin e gabimeve , e cila është shqyrtuar dhe miratuar në seance të rregullt të Kuvendi Komunal të Pejës , me vendimin nr.350/02-15034, datë 29.04.2026.

Më pas Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, përmes aktit administrativ nr.2356-2/26 datë 28.05.2026, ka kërkuar rishqyrtimin e ligjshmërisë së këtij akti.

Pas pranimit të këtij akti Dejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit ka bërë rishqyrtimin e plotë të qështjes , duke analizuar dhe krahasuar gjendjen faktike në teren me dokumentet planifikuese në fuqi.

Gjatë këtij procesi janë trajtuar edhe disa raste konkrete për të cilat Komuna e Pejës , nuk ka mundur të lëshoj Leje Ndërtimore në pëputhje me Planin Zhvillimor dhe Harten Zonale të Komunës së Pejës.

Në këto raste , palët e prekura kanë ushtruar ankesa ndaj vendimeve të Drejtorise së Urbanizmit.

Në shkallën e dytë , të Ministrise së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar këto ankesa dhe kanë nxjerrë vendime duke i aprovuar ato si të bazuara , duke vendosur në favor të palëve ankuese.

Andaj me qëllim të harmonizimit të plote të dokumenteve planifikuese dhe eliminimit të lëshimeve teknike dhe juridike të evidentuara, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisit vlerëson se është e nevojshme të procedohet me plotësimin e pjesshëm të Hartes Zonale të Komunës së Pejës. në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Në Planin Zhvillimor Komunal, Komuna e Pejës ka parapare dy zoa si pjesë e zhvillimit për kategori sporti dhe rekreacioni në pjesët e parcelave publike me interes për zhvillimin e sportit ku është paraparë vetëm kjo kategori.

Ndërsa në Harten Zonale , në pjesë grafike janë përfshirë edhe pronat tjera në ngastart kadastrale të Brestovikut, Majës së Zezë dhe një pjesë të qytetit, të cilat urgjentisht duhet të largohen, pasi cenohet zhvillimi pronave tjera dhe për të cilat Komuna e Pejës nuk ka interes publik për shpronësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	DC
Nr. Prot. Broj.Prot. Prot.No.	2358-2/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	02-
Data. Datum: Date.	28.05.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në VL 74/26 MMPH Datë: 25.05.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor i Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimit Nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023-2031

I nderuar kryetar Muhaxheri,
I nderuar kryesues Kurtbogaj

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 05.05.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendimin Nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023-2031**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal së Pejës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimit Nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023-2031

ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

Vendimi duhet të përmbaj arsyetimin për ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës, pasi që sipas Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor Neni 11. Përgjegjësit e Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim Hapësinor, paragrafi 1. Autoriteti përgjegjës Komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në pajtim me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për: nën-paragrafi 1.7. revidim të Hartës Zonale të Komunës katër (4) vite pas miratimit përfundimtar të tij, sipas procedurës së përcaktuar për hartimin dhe miratimin e tyre paraprak, në rast se nga të gjitha masat e parapara në Hartën Zonale të Komunës për këtë periudhë, më pak se dyzet përqind (40%) të jenë zbatuar.

-Ndryshimi i Hartës Zonale të Komunës duhet të jetë në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal sipas Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor Neni 16, paragrafi 3. Hartimi i Hartës Zonale të Komunës bazohet në: nën-paragrafi 3.4. Hartën Zonale të Kosovës, Planin Zhvillimor Komunal dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Sa i përket Raporteve të Zbatimit dhe Monitorimit të Hartës Zonale të Komunës së Pejës duke ju referuar Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 10 Përgjegjësit e Kuvendit Komunal në Planifikimin Hapësinor paragrafi 3. Kuvendi Komunal në baza vjetore shqyrton Raportin monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës, si dhe Planet Rregulluese të Hollësishme të përgatitur nga Drejtoratet sektoriale të Komunës.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.





**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR ORGANIZIMIN E KONSULTIMEVE
PUBLIKE PËR PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2027**

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

KOMUNA PEJË

GUSHT

2026

1. HYRJE

Ky Raport Përmbledhës është hartuar me qëllim të dokumentimit të të gjitha aktiviteteve dhe formave të konsultimit publik që i kanë paraprirë hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027. Raporti paraqet mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të procesit të konsultimeve publike, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit, si dhe trajtimin e komenteve, kërkesave dhe propozimeve të paraqitura gjatë procesit të planifikimit buxhetor. Procesi i konsultimeve publike është zhvilluar në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies, pjesëmarrjes qytetare dhe qeverisjes së mirë, duke krijuar mundësi që qytetarët dhe grupet e interesit të kontribuojnë në përcaktimin e prioritetëve zhvillimore të Komunës së Pejës.

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, konsultimi publik paraqet një nga mekanizmat kryesorë për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes lokale. Ky udhëzim përcakton parimet, format, procedurat dhe standardet minimale që komunat duhet të zbatojnë gjatë hartimit të politikave dhe akteve komunale, duke garantuar transparencën institucionale dhe pjesëmarrjen aktive të publikut. Në këtë kuadër, Komuna e Pejës ka zhvilluar forma të ndryshme të konsultimit publik, të cilat përfshijnë:

- Takimet publike;
- Konsultimet publike për dokumentet strategjike dhe politikat komunale;
- Takimet konsultative me qytetarët; Dëgjimet buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe
- Projekt-Buxhetin e vitit 2027.

Gjatë gjithë procesit janë siguruar njoftimi publik, materialet prezantuese, procesverbalet, listat e pjesëmarrësve dhe dokumentimi i plotë i aktiviteteve të zhvilluara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procesi i hartimit të Projekt-Buxhetit është zhvilluar gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili përcakton procedurat për përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit komunal. Në bazë të këtij ligji, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Kryetari i Komunës janë përgjegjës për organizimin e procesit të planifikimit buxhetor, përgatitjen e qarkores buxhetore komunale, koordinimin me drejtoritë komunale dhe hartimin e Projekt-Buxhetit, i cili i dorëzohet Kuvendit Komunal brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Pejës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe Qarkoren Buxhetore për përgatitjen e buxhetit komunal, Komuna e Pejës ka organizuar procesin e konsultimeve publike për hartimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Për organizimin e këtij procesi, me Vendimin Nr. 400/01-36008/2026, të datës 26.05.2026, Kryetari i Komunës ka emëruar Grupin Punues përgjegjës për koordinimin, organizimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me konsultimet publike. Në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, drejtoritë komunale dhe Zyrën për Informim Publik janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e konsultimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe organizimin e njëmbëdhjetë dëgjimeve buxhetore publike për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

Ky raport paraqet në mënyrë kronologjike organizimin e procesit të konsultimeve publike, format e konsultimit të zhvilluara, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit, mënyrën e pranimit të kërkesave dhe propozimeve, si dhe trajtimin e tyre gjatë hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

2. ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN DHE HARTIMIN E PROJEKT-BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2027

2.1 Grupi Punues për organizimin dhe planifikimin e konsultimeve publike

Për organizimin dhe koordinimin e procesit të konsultimeve publike për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027, Kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri, me Vendimin Nr. 400/01-36008/2026, të datës 26.05.2026, ka emëruar Grupin Punues përgjegjës për planifikimin, organizimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me procesin e konsultimeve publike.

Grupi Punues është ngarkuar me detyrën që të sigurojë zhvillimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe efektiv të konsultimeve publike, duke krijuar mundësi për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, përfaqësuesve të bashkësive lokale, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe grupeve të tjera të interesit.

Në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, drejtoritë komunale dhe Zyrën për Informim Publik, Grupi Punues ka koordinuar përgatitjen e dokumentacionit, organizimin e konsultimeve publike, publikimin e njoftimeve, zhvillimin e dëgjimeve buxhetore dhe dokumentimin e të gjithë procesit.

2.2 Konsultimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029

Në kuadër të procesit të planifikimit të Projekt-Buxhetit për vitin 2027, Komuna e Pejës ka organizuar konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029. Materialet për konsultim publik janë përgatitur nga Grupi Punues në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe janë publikuar paraprakisht për informimin e qytetarëve dhe palëve të interesuara.

Konsultimi publik është mbajtur më **19 qershor 2026**, në ora **12:00**, në Sallën e Kuvendit Komunal të Pejës.

Qëllimi i këtij konsultimi ka qenë prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, informimi i qytetarëve mbi prioritetet zhvillimore të komunës, si dhe mbledhja e komenteve, propozimeve dhe rekomandimeve që do të shërbenin gjatë hartimit të Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dokumentacioni i konsultimit publik

- Njoftimi për konsultimin publik të KAB 2027-2029:
<https://peja.rks-gov.net/news/njoftim-konsultim-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-2027-2029-kab/>
- Materialet prezantuese:
<https://peja.rks-gov.net/news/konsultimi-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/>
- Procesverbali i konsultimit publik për KAB 2027-2029:



Procesverbal -
Dëgjim Publik 19.06.2

2.3 Organizimi i dëgjimeve buxhetore publike

Pas përfundimit të konsultimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore, Komuna e Pejës ka organizuar dëgjimet buxhetore publike për hartimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Me qëllim të sigurimit të një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, është hartuar kalendari i dëgjimeve buxhetore, i cili është publikuar paraprakisht në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës dhe në kanalet zyrtare të informimit.

Në bazë të kalendarit të miratuar janë organizuar **11 dëgjime buxhetore publike**, të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës **03-07 gusht 2026** në qytet dhe në lokalitetet e ndryshme të Komunës së Pejës.

Në këto dëgjime kanë marrë pjesë qytetarë, përfaqësues të bashkësive lokale, organizata të shoqërisë civile, klube sportive, organizata të grave, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe grupe të tjera të interesit.

Gjatë dëgjimeve janë prezantuar prioritetet buxhetore të Komunës së Pejës, ndërsa pjesëmarrësit kanë paraqitur kërkesat, propozimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me investimet kapitale, infrastrukturën publike, shërbimet komunale, subvencionet dhe çështje të tjera me interes për komunitetin.

Ky proces ka kontribuar në rritjen e transparencës, forcimin e dialogut me qytetarët dhe përfshirjen e tyre aktive në procesin e planifikimit buxhetor.

Dokumentacioni i dëgjimeve buxhetore:

- Njoftimi për dëgjimet buxhetore:
<https://peja.rks-gov.net/news/njoftim-per-degjime-publike-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-pejes-per-vitin-2027/>
- Kalendari i dëgjimeve buxhetore;
<https://peja.rks-gov.net/news/njoftim-per-degjime-publike-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-pejes-per-vitin-2027/>
- Materialet prezantuese:
<https://peja.rks-gov.net/news/degjimet-publike-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-pejes-per-vitin-2027/>
- Procesverbalet dhe listat e pjesëmarrësve:
https://peja.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Komplet-procesverbalet-e-ndegjimeve-buxhetore-2027-2029_compressed.pdf

PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKT-BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Përmbajtja	Përshkrimi	Dokumentacioni / Linku
Formimi i Grupit Punues	Grupi Punues për planifikimin, koordinimin dhe organizimin e konsultimeve publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027 është formuar me vendim të Kryetarit të Komunës më 26 maj 2026 . Grupi Punues ka qenë përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve të konsultimit publik gjatë procesit të hartimit të buxhetit.	VENDIMI PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES - dokument zyrtar i Komunës së Pejës  vendimi.pdf
Përgatitja e planit dhe kalendarit të konsultimeve	Materialet për konsultimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 janë përgatitur para mbajtjes së konsultimit publik, ndërsa kalendarit i dëgjimeve buxhetore është përgatitur dhe publikuar më 30.06.2026 .	NJOFTIMI PËR KAB 2027-2029 KALENDARIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE https://peja.rks-gov.net/news/njoftim-konsultim-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-2027-2029-kab/ ; https://peja.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/orari-i-ndegjimeve-buxhetore.pdf ;
Konsultimi publik për KAB 2027-2029	Konsultimi publik është mbajtur më 19.06.2026 , në Sallën e Kuvendit Komunal të Pejës. Qëllimi i konsultimit ishte prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe mbledhja e komenteve, propozimeve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe grupet e interesit.	NJOFTIMI PËR KAB, MATERIALET PËR KAB, PROCESVERBALET PËR KAB https://peja.rks-gov.net/news/njoftim-konsultim-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-2027-2029-kab/ https://peja.rks-gov.net/news/konsultimi-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/ ;  Procesverbal - Dëgjim Publik 19.06.2

Përmbajtja	Përshkrimi	Dokumentacioni / Linku
Dëgjimet buxhetore për Projekt-Buxhetin 2027	Janë organizuar gjithsej 11 dëgjime buxhetore publike , të mbajtura gjatë periudhës 03-07 gusht 2026 , në qytet dhe në lokalitetet e Komunës së Pejës. Gjatë këtyre dëgjimeve qytetarët kanë paraqitur kërkesat, propozimet dhe prioritetet e tyre për investimet dhe shpenzimet publike të vitit 2027.	LINKU I NJOFTIMIT DHE MATERIALEVE PËRCJELLËSE PËR DËGJIMET BUXHETORE https://peja.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/orari-i-ndegjimeve-buxhetore.pdf ; https://peja.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Komplet-procesverbalet-e-ndegjimeve-buxhetore-2027-2029_compressed.pdf
Konsultimet me mekanizmat lokalë	Gjatë procesit të planifikimit buxhetor janë zhvilluar konsultime të vazhdueshme me Këshillat e Fshatrave dhe Bashkësitë Lokale, me qëllim identifikimin e nevojave dhe prioritetëve të komunitetit. Përfaqësuesit lokalë kanë kontribuar në informimin dhe mobilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje në konsultimet publike dhe dëgjimet buxhetore.	N/A
Takimet e Kryetarit me qytetarët	Kryetari i Komunës ka vazhduar praktikën e takimeve të rregullta me qytetarët, ku janë trajtuar kërkesa dhe iniciativa që lidhen me investimet kapitale, subvencionet, infrastrukturën, shërbimet publike dhe çështje të tjera me interes për komunitetin. Propozimet e qytetarëve janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të Projekt-Buxhetit 2027.	N/A
Kërkesat e pranuar me shkrim	Përveç pjesëmarrjes në dëgjimet publike, qytetarët kanë pasur mundësi të paraqesin kërkesa dhe komente edhe në formë elektronike dhe fizike, përmes adresave zyrtare elektronike dhe protokollit të Komunës. Të gjitha propozimet janë evidentuar dhe shqyrtuar nga Grupi Punues gjatë hartimit të Projekt-Buxhetit.	 Kërkesat e paraqitura nga Fëmijëpër fshatrat e Lugut t  Kërkesat prioritare

3. PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE PUBLIKE TË MBAJTURA PËR PROJEKT-BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Tabela në vijim paraqet në mënyrë përmbledhëse të gjitha konsultimet publike të organizuara gjatë procesit të hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027, duke përfshirë konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe dëgjimet buxhetore të organizuara me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit.

Grupi i interesit / Dëgjimi publik	Data dhe ora	Lokacioni	Nr. i pjesëmarrësve	Gra Burra		Nr. i kërkesave
Konsultimi publik për KAB 2027-2029	19.06.2026 12:00	Salla e Kuvendit Komunal në Pejë	38	8	30	6
OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile dhe klubet sportive	03.08.2026 12:00	Salla e Kuvendit Komunal në Pejë	20	12	8	8
Bashkësitë Lokale të qytetit	03.08.2026 16:00	Salla e Kuvendit Komunal në Pejë	32	9	23	12
Banorët e fshatrave të Rugovës	03.08.2026 18:00	Salla e Kuvendit Komunal në Pejë	21	4	17	7
Banorët e fshatrave Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull	04.08.2026 16:30	SHFMU "Ali Kelmendi", Nabërgjan	23	1	22	3
Banorët e fshatrave Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim	04.08.2026 18:00	Qendra Rinore në Vitomiricë	23	5	18	6
Banorët e fshatrave të Podgurit	05.08.2026 17:30	SHFMU në Novosellë	16	4	12	10
Banorët e fshatit Gorazhdec	05.08.2026 16 :00	Qendra Rinore në Gorazhdec	13	0	13	5
Gra, vajza, klubet sportive të vajzave, organizatat e grave dhe organizatat që veprojnë në fushën e barazisë gjinore	06.08.2026 16:00	Salla e Kuvendit Komunal në Pejë	11	9	2	2
Banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq	06.08.2026 17:30	SHFMU në Raushiq	16	2	14	6
Banorët e fshatrave të Lugut të Baranit	07.08.2026 17:30	SHFMU "Dëshmorët e Kombit", Baran	30	0	30	10
Banorët e fshatrave të Lugut të Leshanit	07.08.2026 19:00	SHFMU "Skënder Çeku", Qyshk	3	0	3	0
TOTAL			246	54	192	75

Analizë e pjesëmarrjes

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se gjatë procesit të konsultimeve publike për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 janë organizuar gjithsej **12 aktivitete konsultuese**, duke përfshirë një konsultim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe **11 dëgjime buxhetore** me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit.

Procesi është karakterizuar nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve, përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, bashkësive lokale, grave, të rinjve, klubeve sportive dhe grupeve të tjera të interesit, të cilët kanë paraqitur propozimet dhe prioritetet e tyre për zhvillimin e Komunës së Pejës gjatë vitit 2027.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, struktura gjinore dhe numri i kërkesave të pranuar paraqiten në tabelën e mësipërme dhe analizohen në kapitujt vijues të këtij raporti.

4. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura nga qytetarët dhe palët e interesuara, brenda afateve dhe mënyrave të përcaktuara, përfshihen në raportin për rezultatet e konsultimeve publike.

Shqyrtimi i kërkesave është realizuar nga Grupi Punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027, i cili, në bashkëpunim me drejtoritë komunale kompetente, ka vlerësuar secilën kërkesë sipas prioriteteve zhvillimore, kompetencave ligjore dhe mundësive buxhetore të komunës.

Për të siguruar transparencë dhe një trajtim të barabartë të të gjitha kërkesave, është përdorur metodologjia e mëposhtme për klasifikimin e statusit të tyre.

Pranuar / Aprovuar

Ky status u jepet kërkesave që janë vlerësuar si prioritare dhe të realizueshme, në përputhje me kompetencat e Komunës së Pejës dhe mundësitë buxhetore. Kërkesat me këtë status janë përfshirë në Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe do të procedohen për miratim në Kuvendin Komunal.

Adresuar

Ky status u jepet kërkesave që nuk bien në kompetencën e Komunës së Pejës ose që lidhen me institucione të tjera përgjegjëse, si p.sh. kompanitë publike apo institucionet qendrore. Në këto raste kërkesa përcillet tek institucioni kompetent për shqyrtim.

Ky status përdoret edhe për kërkesat që tashmë janë të përfshira në projekte ekzistuese komunale ose janë planifikuar të shqyrtohen gjatë planifikimeve buxhetore të viteve në vijim.

Pjesërisht e pranuar / Aprovuar

Ky status përdoret kur kërkesa përmban disa komponentë, ndërsa për shkak të kufizimeve buxhetore ose prioriteteve zhvillimore mund të realizohet vetëm një pjesë e saj.

Në këto raste, Komuna arsyeton pjesën që do të realizohet në kuadër të Projekt-Buxhetit 2027, ndërsa pjesa tjetër mbetet për shqyrtim në planifikimet e ardhshme.

Refuzuar

Ky status u jepet kërkesave që nuk mund të përfshihen në Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Arsyet mund të jenë, ndër të tjera:

- mungesa e mjeteve buxhetore;
- kërkesa nuk përbën prioritet publik;
- kërkesa është e natyrës individuale dhe nuk ka ndikim të gjerë në komunitet;
- ekzistojnë pengesa juridike ose pronësore;
- realizimi i saj nuk është në kompetencën e Komunës së Pejës.

5. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT TË TYRE

Në këtë kapitull paraqiten të gjitha kërkesat, propozimet, komentet dhe sugjerimet e pranura gjatë procesit të konsultimeve publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027. Për lehtësi të analizës dhe trajtimit, kërkesat janë klasifikuar sipas kategorive ekonomike dhe sipas statusit të dhënë nga Grupi Punues. Kërkesat janë grupuar në këto kategori:

- **Projektet Kapitale**
- **Subvencionet dhe Transferet**
- **Mallrat dhe Shërbimet**
- **Pyetje, kërkesa për informim dhe sugjerime të ndryshme**

Tabela në vijim përmban këto elemente:

Kategoria e kërkesës

Tregon nëse kërkesa i përket kategorisë së Investimeve Kapitale, Subvencioneve dhe Transfereve, Mallrave dhe Shërbimeve ose Pyetjeve dhe Kërkesave për Informim.

Kërkesa / Propozimi

Përshkrimi i plotë i kërkesës, propozimit ose sugjerimit të paraqitur nga qytetari, organizata apo grupi i interesit.

Parashtruesi i kërkesës

Emri dhe mbiemri i qytetarit ose emri i organizatës që ka paraqitur kërkesën.

Statusi i kërkesës

Paraqet statusin e kërkesës sipas metodologjisë së përcaktuar në Kapitullin 4, përkatësisht:

- Pranuar / Aprovuar
- Pjesërisht e pranuar
- Adresuar
- Refuzuar

Arsyetimi i Komunës

Përmban përgjigjen zyrtare dhe arsyetimin e Grupit Punues për statusin e secilës kërkesë, duke sqaruar në mënyrë të qartë bazën ligjore, financiare, teknike ose zhvillimore mbi të cilën është marrë vendimi.

Kërkesat e pranuar si rezultat i konsultimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe dëgjimeve publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Në tabelat në vijim janë paraqitur të gjitha kërkesat, propozimet, komentet dhe sugjerimet e paraqitura nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe grupet e tjera të interesit gjatë procesit të konsultimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe dëgjimeve publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Kërkesat janë sistemuar sipas kategorive ekonomike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues në bashkëpunim me drejtoritë komunale përkatëse dhe janë klasifikuar sipas statusit të tyre, në përputhje me metodologjinë dhe kriteret e paraqitura në kapitullin paraprak.

Nr.	Kërkesat, sugjerimet, idetë e parastruara në konsultim	Kategoria	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
1	Shefqet Kelmendi Paraqiti kërkesën për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës në lagjen ku banon. Ai theksoi se gjendja aktuale e rrugës vështirëson qarkullimin e banorëve dhe kërkoi që ky projekt të trajtohet si prioritet në planifikimin e investimeve kapitale.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës do të shqyrtohet nga drejtoritë kompetente gjatë procesit të planifikimit buxhetor. Mundësia e realizimit të saj do të vlerësohet në bazë të prioritetëve të përcaktuara, gjendjes së infrastrukturës dhe mundësive buxhetore të Komunës së Pejës.
2	Agim Haxhijaj Shprehu shqetësimin për gjendjen e rrugëve lokale dhe nevojën për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Ai potencoi se investimet në këtë fushë do të ndikonin drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së jetës së banorëve	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa për përmirësimin e infrastrukturës rrugore do të adresohet për shqyrtim nga drejtoritë kompetente gjatë planifikimit të projekteve infrastrukturore. Mundësia e realizimit të intervenimeve do të vlerësohet në bazë të gjendjes së rrugëve, prioritetëve të përcaktuara dhe mundësive buxhetore të Komunës së Pejës.
3	Xhevat Kajolli Paraqiti tri kërkesa prioritare: Përmirësimin e infrastrukturës rrugore;Rregullimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik;Mbështetjen e projekteve të tjera me interes për komunitetin lokal.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesat për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, rregullimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik, si dhe mbështetjen e projekteve me interes për komunitetin lokal, do të adresohen për shqyrtim nga drejtoritë kompetente. Mundësia e realizimit të tyre do të vlerësohet në bazë të prioritetëve të përcaktuara, nevojave të komunitetit dhe mundësive buxhetore të Komunës së Pejës.

4	Agim Nikqi Kërkoi investime në rrugët e lagjes së tij dhe përmirësimin e infrastrukturës lokale, duke potencuar nevojën për qasje më të mirë dhe kushte më të përshtatshme për banorët.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa për investime në rrugët e lagjes dhe përmirësimin e infrastrukturës lokale do të merret në konsideratë gjatë planifikimit të projekteve kapitale. Prioriteti dhe mundësia e realizimit do të përcaktohen pas vlerësimit të nevojave në terren, rëndësisë së intervenimit dhe mundësive buxhetore të Komunës së Pejës.
5	Jakup Lajqi Paraqiti kërkesë për rregullimin e rrugëve lokale dhe trajtimin e problemeve infrastrukturore të evidentuara nga banorët. Ai kërkoi që këto investime të përfshihen në planifikimin e ardhshëm buxhetor.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa për rregullimin e rrugëve lokale dhe trajtimin e problemeve infrastrukturore do të shqyrtohet në kuadër të planifikimit të ardhshëm të investimeve kapitale. Përfshirja e këtyre intervenimeve do të varet nga prioritetet e identifikuar, gjendja në terren dhe mundësitë buxhetore në dispozicion.
6	Kadri Mavraj Paraqiti disa kërkesa me interes për komunitetin: Mirëmbajtjen dhe trajtimin e rrugëve lokale; Përmirësimin e infrastrukturës publike; Investime në projekte zhvillimore dhe shërbime që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesat për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, përmirësimin e infrastrukturës publike dhe realizimin e projekteve me interes për komunitetin do të shqyrtohen nga sektorët kompetentë. Prioritetet për intervenim do të përcaktohen duke marrë parasysh nevojat e evidentuara të komunitetit, rëndësinë e projekteve dhe kapacitetet buxhetore të Komunës së Pejës.
7	Kanita Shala: Jam nxënëse e shkollës fillore “Dardania” në Pejë, ne anëtarët e Asamblesë Komonale të Fëmijëve (AKF), së bashku me fëmijët e grupit Respect Our Rights (ROR), kemi kënaqësinë të jemi pjesë e këtij dëgjimi buxhetor për vitin 2027. Sot para jush, po paraqesim disa kërkesa, që lidhen drejtpërdrejt me interesin më të mirë të fëmijëve dhe bashkëmoshatarëve tanë, në përputhje me detyrimet, që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës.	Pyetje, kërkesa për informim dhe sugjerime të ndryshme	Adresuar	Kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e Asamblesë Komonale të Fëmijëve dhe grupit Respect Our Rights (ROR) do të shqyrtohen me kujdes nga Grupi Punues dhe drejtoritë komunale kompetente, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijëve, prioritetet e identifikuar dhe mundësitë buxhetore të Komunës së Pejës. Kërkesat konkrete do të trajtohen sipas natyrës dhe fushës përkatëse të përgjegjësisë.

	Kërkesat e Asamblesë Komunale të Fëmijëve janë:			
8	Blerja dhe furnizimi me banka të reja dhe të përshtatshme për nxënësit: Ndërrimi i bankave të vjetra, të dëmtuara ose jo ergonomike me mobilje të reja, të përshtatshme me moshën dhe nevojat fizike të nxënësve. Përdorimi i mobiljeve, që përmbushin standardet ergonomike, duke ofruar rehati dhe duke ndihmuar përqendrimin në procesin mësimor.	Mallrat dhe Shërbimet	Pranuar	Kërkesa për blerjen dhe furnizimin me banka të reja dhe të përshtatshme për nxënësit është marrë në konsideratë, pasi lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore dhe krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor. Furnizimi me inventar shkollor do të trajtohet në kuadër të planifikimit buxhetor dhe prioritetet e Drejtorisë përkatëse, në përputhje me nevojat e evidentuara dhe mundësitë buxhetore.
9	Rritja e sigurisë në objektet shkollore: Vendosja e kamerave të sigurisë dhe sigurimi i pranisë së stafit mbikëqyrës, veçanërisht gjatë pushimeve dhe pas përfundimit të orarit mësimor. Hartimi i planeve të evakuimit dhe organizimi i ushtrimeve praktike për reagim në raste emergjente (zjarr, tërmet etj.). Mbyllja e hyrjeve të pasigurta dhe kontrolli i vizitorëve në ambientet shkollore.	Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa lidhur me rritjen e sigurisë në objektet shkollore është marrë në konsideratë dhe do të trajtohet në bashkëpunim me institucionet dhe drejtoritë kompetente. Masat që kanë të bëjnë me përmirësimin e sigurisë, përfshirë vendosjen e pajisjeve të nevojshme, përgatitjen e planeve të evakuimit dhe organizimin e aktiviteteve për reagim në raste emergjente, do të shqyrtohen në përputhje me nevojat prioritare dhe mundësitë buxhetore të Komunës. Ndërsa kërkesat që lidhen me angazhimin e stafit shtesë mbikëqyrës ose masa të tjera që kërkojnë planifikim të veçantë institucional, do të trajtohen në kuadër të kompetencave dhe mundësive në dispozicion.

10	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve pranë shkollave: Ndërtimi i trotuareve të sigurta në afërsi të shkollave, ku ato mungojnë, për të mbrojtur nxënësit gjatë lëvizjes për në shkollë dhe kthimit në shtëpi. Vendosija e pengesave fizike për të parandaluar parkimin e automjeteve në trotuare nga prindërit, stafi i shkollës apo drejtuesit e tjerë të automjeteve. Sigurimi i ndriçimit të mjaftueshëm dhe sinjalizimit të duhur për këmbësorët pranë shkollave.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e trotuareve pranë objekteve shkollore është marrë në konsideratë, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e nxënësve dhe përmirësimin e infrastrukturës publike. Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve në zonat prioritare, si dhe përmirësimi i ndriçimit dhe sinjalizimit rrugor, do të shqyrtohen në kuadër të projekteve dhe mundësive buxhetore të Komunës për vitin 2027. Ndërsa masat shitesë, si vendosja e pengesave fizike për parandalimin e parkimit në trotuare, do të trajtohen në bashkëpunim me institucionet dhe drejtoritë kompetente, në varësi të nevojave dhe mundësive për realizimin e tyre.
11	Pajisja e shkollave me kabinete të teknologjisë informative: Modernizimi i kabineteve të informatikës me kompjuterë të rinj dhe pajisje bashkëkohore. Sigurimi i internetit me shpejtësi të lartë dhe programeve edukative, që mbështesin zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve. Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për mësimmshënësit, për përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.	Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për pajisjen dhe modernizimin e kabineteve të teknologjisë informative në shkollë është marrë në konsideratë, duke vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të aftësive digjitale të nxënësve dhe përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor. Furnizimi me pajisje kompjuterike, përmirësimi i infrastrukturës teknologjike dhe sigurimi i programeve të nevojshme edukative do të shqyrtohen në përputhje me nevojat prioritare dhe mundësitë buxhetore të Komunës për vitin 2027. Ndërsa çështjet që lidhen me sigurimin e internetit, mirëmbajtjen e vazhdueshme të pajisjeve dhe organizimin e trajnimeve për mësimmshënësit do të trajtohen në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe në kuadër të mundësive dhe përgjegjësi përkatëse.

12	Sara Camaj: Jam nxënëse në SHFMU “Lidhja e Pejës” në Novosellë, po i lexoj disa nga kërkesat, siç janë: 5.Buxhet shtesë për përmirësimin e higjienës në shkolla: Investime për përmirësimin e kushteve sanitare në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.Sigurimi i ujit të rrjedhshëm, sapunit dhe letrës higjienike në të gjitha tualetet.Pastrim i rregullt dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e ambienteve sanitare.	Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për përmirësimin e higjienës dhe kushteve sanitare në shkolla është marrë në konsideratë, duke vlerësuar rëndësinë e sigurimit të një ambienti të pastër, të sigurt dhe të përshtatshëm për nxënësit dhe stafin arsimor. Sigurimi i materialeve të nevojshme higjienike, mirëmbajtja dhe pastrimi i rregullt i ambienteve sanitare do të trajtohen në kuadër të nevojave prioritare dhe mundësive buxhetore për vitin 2027. Ndërsa investimet më të mëdha që lidhen me renovimin ose përmirësimin e infrastrukturës sanitare do të shqyrtohen sipas gjendjes dhe nevojave konkrete të objekteve shkollore, në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
13	Punësimi i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta:Sigurimi i asistentëve profesionalë për nxënësit me nevoja të veçanta, në mënyrë që ata të marrin mbështetjen e nevojshme gjatë procesit mësimor.Trajnimi i mësimeve për qasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetje individuale për secilin nxënëse.Krijimi i kushteve për një mjedis mësimor gjithëpërfshirës, ku të gjithë fëmijët të kenë mundësi të barabarta për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.	Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për sigurimin e mbështetjes profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta është marrë në konsideratë, duke vlerësuar rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës dhe krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë nxënësit. Sigurimi i mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta dhe përmirësimi i kushteve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor do të trajtohen në përputhje me nevojat e identifikuar, kompetencat institucionale dhe mundësitë buxhetore. Ndërsa angazhimi i asistentëve shtesë dhe organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për mësimeve do të shqyrtohen në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat kompetente, duke u bazuar në nevojat konkrete dhe mundësitë për realizimin e tyre gjatë vitit 2027.

14	Kërkesë për mbështetjen e Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve në shkollë. Nxënësja kërkoi që në Buxhetin Komunal për vitin 2027 të planifikohet një linjë e veçantë buxhetore për fëmijët dhe mbështetjen e aktiviteteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve, duke përfshirë aktivitete ndërgjegjëse, punëtori edukative, tryeza të rrumbullakëta dhe mbështetje për parandalimin e bullizmit dhe diskriminimit. Gjithashtu, si nxënëse e SHFMU “Lidhja e Pejës”, kërkoi pajisjen e bibliotekës me libra të rinj, pajisjen e kabineteve me dollape dhe mjete mësimore, përfshirë kabinetet e gjeografisë, fizikës dhe kimisë, me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së mësimi. Kërkesa u paraqit me qëllim që këto prioritete të merren parasysh gjatë hartimit të Buxhetit Komunal për vitin 2027 dhe të evidentohen në procesverbalin e dëgjimit buxhetor.	Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për mbështetjen e aktiviteteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe përmirësimin e kushteve në shkollë është marrë në konsideratë gjatë hartimit të Buxhetit Komunal për vitin 2027. Aktivitetet që lidhen me edukimin, ndërgjegjësimin, parandalimin e bullizmit dhe diskriminimit, si dhe iniciativa të tjera në interes të fëmijëve, do të shqyrtohen në kuadër të programeve dhe mundësive buxhetore të Komunës. Gjithashtu, kërkesat për pajisjen e bibliotekës me libra të rinj, furnizimin e kabineteve me dollape dhe mjete mësimore për lëndë të ndryshme do të trajtohen sipas nevojave prioritare të institucioneve arsimore dhe mundësive buxhetore në dispozicion. Kërkesa për krijimin e një linje të veçantë buxhetore do të shqyrtohet në kuadër të strukturës dhe planifikimit buxhetor, ndërsa realizimi i të gjitha komponentëve të kërkesës do të varet nga prioritetet dhe mundësitë financiare të Komunës për vitin 2027.
----	---	-----------------------	---------------------------------	---

15	Fitore Haxhihasani: Mbështetja për personat me aftësi të kufizuara Fitore Haxhihasani, përfaqësuese e OJQ-së “Qendra për Jetë të Pavarur”, kërkoi që personat me aftësi të kufizuara, fizike dhe mendore, të jenë prioritet, si dhe të rritet mbështetja financiare për organizatat që ofrojnë shërbime për këtë kategori. Kërkoj që nga viti 2027 të sigurohet mbështetje e mjaftueshme dhe e qëndrueshme për këto organizata, në mënyrë që të mos rrezikohet vazhdimësia e shërbimeve ditore për përfituesit. Gjithashtu, kërkoi që të shqyrtohet ndërtimi i objektit të ri për “Qendrën për Jetë të Pavarur”, me qëllim të zgjerimit të shërbimeve dhe përfshirjes së më shumë përfituesve.	Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësitë buxhetore për rritjen dhe sigurimin e mbështetjes për organizatat që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, si dhe mundësinë e përfshirjes së mbështetjes për infrastrukturën dhe zgjerimin e shërbimeve për këtë kategori, në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore.
16	Xhevat Kajolli: Banoj në rrugën “Gazmend Zajmi”. Banorët e kësaj rruge i kanë tri kërkesa. E para është, është kryer pjesërisht: janë futur gypat e ujit, gypi kryesor dhe anësor, por lidhja me orë nuk është bërë. Kërkesa e dytë është shtyllat elektrike, që janë para objekteve, para shtëpive, të zëvendësohen. Kemi qenë në KESCO, te drejtori. Ai na ka thënë se Komuna duhet ta bëjë planin gjeneral për t’i futur në buxhet, pastaj kabllot na i shtrojmë. Kërkesa tjetër është rruga, e cila totalisht është shkatërruar. I kanë futur ato gypat e ujës-jellës, po ka shumë kalimtarë aty prej Çarshisë së Gjatë te Restaurant Prizreni. Është një rrugicë.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht. Punimet për rrjetin e ujës-jellësit janë realizuar pjesërisht, ndërsa për përfundimin e lidhjeve do të shqyrtohet mundësia e realizimit në koordinim me institucionet përkatëse. Kërkesa për përmirësimin e rrjetit elektrik do të adresohet në bashkëpunim me KESCO-n, ndërsa rehabilitimi i rrugës do të shqyrtohet në kuadër të prioritetëve dhe mundësive buxhetore të Komunës.

17	Petrit Tigani: Jam nga lagjja “Jarinë”, fillimi i rrugës “Shpëtim Bojku”. Ne jemi të gjithë banorët e banesës kolektive dhe të gjithë po heqim për një lift. Edhe në hyrjen tonë janë disa invalidë, ku kojshiu Ahmeti është pa dy këmbë. Në katin e pestë është Gëzim Broqi, që 11 vite me pampersa, edhe kojshiu Hasani e ka djalin me sëmundje të keqe. Kemi nevojë urgjente për një lift. Nuk është investim i madh, por na shpëton, se jemi 14 familje, banesa jonë, hyrja A. Ka vend me e vendos liftin dhe të gjithë jemi pajtuar, që nëse ka nevojë të kontribuojmë, kontribuojmë edhe vetë, që të kryhet puna sa më shpejt. Unë vetë jetoj në katin e gjashtë, por fatmirësisht jemi mirë dhe të shëndoshë, por janë edhe një familje me fëmijë të vegjël, të cilët po heqin shumë me ata fëmijë.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e realizimit të projektit për vendosjen e liftit në objektin kolektiv, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të banorëve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me fëmijë. Realizimi do të varet nga mundësitë buxhetore dhe procedurat përkatëse.
18	Skënder Gashi: Do t'i bashkëngjitem kolegut, që ne banojmë në katin e shtatë. E kemi një djalë me sëmundje të rëndë, i cili pa ndihmën tonë s'mundet me lëviz asnjë moment. Nënë e kemi 80 vjeçare dhe i kemi disa kojshi me raste shumë të rënda dhe do të ishte mirë të na ndihmoni ta qesim këtë lift. Nuk kushton shumë për Komunën, në bazë të ofertave, që i kemi marrë për lifta, dhe shpresojmë të na ndihmoni.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e mbështetjes për vendosjen e liftit në objektin kolektiv, duke marrë parasysh nevojat e banorëve dhe rastet sociale e shëndetësore të paraqitura. Realizimi i kërkesës do të varet nga mundësitë buxhetore dhe procedurat përkatëse.

19	Feriz Lukaj: Jam mërgimtar nga Gjermania. Kemi nevojë për ujë. Që tri vjet ujë s'kemi qysh duhet. Unë jam vetë i 10-ti, ndërsa 8 anëtarë mu kthyen për Gjermani, se nuk kanë pasur ujë. Rruga është "Ahmet Rexhaj". Unë ose duhet me e qitë shtëpinë në shitje, që tri vjet s'kam ujë. Kur i kemi pasur gypat më të vjetër, kemi pasur më shumë ujë se që i kemi vendosur gypat e rinj. Kam dhënë kontribut për 35 vjet për këtë vend, për Pejë, për Kosovë, e sot me mbet pa ujë unë. Po ashtu, familja nuk pushuan siç duhet dhe janë kthyer në Gjermani. Kaq! Ju përshëndes!	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe do të shqyrtohet në bashkëpunim me institucionet dhe ndërmarrjet përkatëse, me qëllim të identifikimit të problemeve në furnizimin me ujë dhe ndërmarrjes së masave për përmirësimin e furnizimit për banorët e kësaj zone, në kuadër të mundësive dhe kompetencave përkatëse.
20	Haki Lajçi: Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam disa kërkesa për Bashkësinë Lokale "Kristali". E kemi problemin me kanalizim në rrugën "Ramë Geci", ku janë mbi 45 shtëpi, pa kanalizim. As shkolla fillore "Smajl Hajdaraj" s'ka. Rruga "Vëllezërit Kastrati", "Gani Daci", që nuk kanë zebra dhe në ato rrugë kalojnë të gjithë nxënësit e shkollës "Smajl Hajdaraj". Rruga "Jeton Dedushaj", e cila është e shkatërruar shumë, ka shumë gropa të mëdha. Ndriçimi është i dobët. Në rrugën "Gani Daci", që t'i kemi policët e shtrirë, janë disa rrugë të paasfaltuara, ndërsa kërkesa është paraqitur. Janë dy rrugë nga 175 metra, të paasfaltuara. Për ndriçim është rruga "Zenel Sylja", janë 27 shtëpi pa ndriçim. Kërkesa është që dy vite, ndriçim nuk kanë. Rruga "Vlora" është e dëmtuar shumë, sepse Hidrodrini e ka dëmtuar në katër vende. Ka edhe kërkesa të tjera, por të gjitha përnjëherë nuk bëhen. Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë dhe prioritetizojë ndërhyrjet e nevojshme në kanalizim, asfaltim dhe rehabilitim të rrugëve, ndriçim publik dhe siguri në komunikacion, duke përfshirë vendosjen e sinjalistikës për këmbësorë pranë shkollës. Realizimi i tyre do të bëhet në përputhje me prioritetet, mundësitë buxhetore dhe kompetencat e institucioneve përkatëse.

21	Kadri Mavraj – Kërkesa për përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurisë në lagjeKadri Mavraj paraqiti disa kërkesa lidhur me përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës në lagjet përkatëse, ndër të cilat: Trajtimi i problemit të furnizimit me ujë në lokacionin të Fabrika e Tullave, përfshirë çështjet që lidhen me pompat dhe reduktimet; Marrja e masave për verifikimin dhe trajtimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, si dhe shqyrtimi i mundësisë për dëmshpërblimin e dëmeve të evidentuara; Rregullimi i kulmeve të dëmtuara në ndërtesat e lagjes “Fidanishte”, veçanërisht në banesat G2 dhe ndërtesën përballë saj; Riparimi i shtyllave të dëmtuara të ndriçimit publik në rrugën “Myrvete Maksutaj”, rrugën “Konferenca e Bujanit” dhe deri të Shkollës e Mesme Ekonomike “Ali Hadri”; Trajtimi i kërkesave për riemërtimin e rrugëve, të cilat janë paraqitur edhe në dëgjimet e mëhershme; Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujërave të zeza dhe kanaleve të hapura, veçanërisht në lagjen “Fidanishte” dhe në pjesë të lagjes “7 Shtatori”; Rregullimi i infrastrukturës dhe ndriçimit në rrugën “Naum Veqilharxhi”, përfshirë çështjet e shpronësimeve dhe vazhdimin e ndriçimit në pjesët ku mungon; Përmirësimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në lagje, duke pasur parasysh se disa zona vazhdojnë të mbeten pa ndriçim. Kërkesat e paraqitura do të evidentohen dhe do të përcillen për shqyrtim dhe trajtim të mëtejshëm nga drejtoritë dhe strukturat kompetente të Komunës së Pejës.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesat janë adresuar dhe do të përcillen për shqyrtim dhe trajtim nga drejtoritë dhe strukturat kompetente të Komunës. Çështjet që lidhen me furnizimin me ujë, ndriçimin publik, rehabilitimin e infrastrukturës, kanalet e ujërave të zeza, dëmet nga fatkeqësitë natyrore dhe kërkesat për riemërtimin e rrugëve do të trajtohen sipas kompetencave përkatëse dhe mundësive buxhetore.
----	--	--------------------	----------	--

22	Shpend Salihaj: Jam Kryetar i Këshillit Lokal Dardania 1 dhe kisha pas dëshirë, që të dija ku ka mbetur puna, edhe pse kam pasur shumë premtime për rrugën “Adrian Krasniqi”. Tash, një pjesë e kishin bërë “Dervish Kryeziu”, me u asfaltu, trotuari edhe ndriçimi, po ashtu edhe rruga “Sali Çeku”. Rrugën, që e lidh rrugën “Adrian Krasniqi” me Qendrën e Mjekësisë Familjare është premtuar të rregullohet trotuari. Asnjë nga punët nuk janë përfunduar, edhe pse janë premtuar shumë herë. Kisha pasur dëshirë të dija ku kanë ngecur punët. Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe do të përcillet për shqyrtim nga drejtoritë kompetente, me qëllim të verifikimit të statusit të projekteve të përmendura dhe identifikimit të çështjeve që kanë ndikuar në mosrealizimin e tyre. Vazhdimi dhe përfundimi i punimeve do të shqyrtohet në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
23	Valbona Avdija – Kërkesa për përfundimin dhe përmirësimin e infrastrukturës Valbona Avdija, Kryetare e Bashkësisë Lokale “2 Korriku”, paraqiti kërkesat në vijim: Asfaltimi i rrugëve dhe segmenteve të mbetura, përfshirë rrugët në pjesën e “Asllan Çeshmës”, “Azem Bejtës”, “Sami Peja”, “Ramiz Xhema” dhe “Beteja e Albulenës”; Rregullimi i ujësjellësit në pjesën e rrugës “Azem Bejta” dhe përfundimi i ndriçimit publik me vendosjen e tri shtyllave të mbetura; Sigurimi dhe rregullimi i kanalit në rrugët “Azem Bejta” dhe “Asllan Çeshme”, përfshirë vendosjen e anësoreve/mbrojtëseve, për shkak të rrezikut për banorët dhe veçanërisht fëmijët; Bashkëpunimi me KEDS-in për rregullimin e shtyllave të ndriçimit publik, ku rreth 4-5 shtylla paraqesin rrezik për banorët. Kërkesat e paraqitura lidhen kryesisht me përfundimin e infrastrukturës së mbetur, rritjen e sigurisë së banorëve dhe përmirësimin e ndriçimit publik në Bashkësinë Lokale “2 Korriku”.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të trajtohen sipas prioriteteve të përcaktuara. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e përfundimit të segmenteve të mbetura të rrugëve, përmirësimit të ujësjellësit dhe ndriçimit publik, si dhe ndërmarrjes së masave për rritjen e sigurisë në zonat e evidentuara. Për çështjet që janë në kompetencë të KEDS-it, do të kërkohet bashkëpunimi i institucionit përkatës.

24	Bejhan Krasniqi: Jam Kryetar i Bashkësisë Lokale “Karagaqi”. Përshëndetje për të gjithë. E kam një kërkesë, prej banorëve të Karagaqit për me u ndërtu një palë shkallë në mes të Postës Numër Pesë dhe Fontanës për me mujt me u ngjit në park lart. Këtë na e kanë premtuar edhe më herët, por shpresojmë që në të ardhmen të kryhet edhe kjo punë. Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e realizimit të projektit për ndërtimin e shkallëve që lidhin zonën pranë Postës Numër 5 me parkun. Realizimi i projektit do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
25	Ardi Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam dy rekomandime dhe një kërkesë, duke iu bashkëngjitur asaj, që e tha Valbona Avdijsa pak më herët në lagjen “2 Korriku”. Lidhur me kërkesën është sa për informacion, se kur pritet të përfundohet kanali i Çokolicës, që ka mbetur segmenti prej kthesës të “Jarina” e deri te ish-Çakorri, se pas asaj pritet të përfundojë edhe asfaltimi i asaj rruge. Edhe si kërkesë tjetër, edhe rekomandim, është në rrugën “Bege Maliqi”. Janë të rrënuara dy shtëpi, i ka rrënuar Komuna, për shkak të përmbajtjeve të mëhershme. Është duke u bërë rregullimi i kanalit, po tash, me ato dy parcela aty, rekomandimi është që njëra nga parcelat të kthehet në park për fëmijë, se qysh e tha edhe Valbona, fëmijët janë rrënuar në kanal, se nuk kanë vend ku të luajnë fëmijët. Si opsion i dytë për parcelën e dytë është të ndërtohet Shtëpia e Komunitetit, se duke e marrë parasysh se Bashkësia Lokale “2 Korriku” është goxha e madhe, nuk e ka asnjë Shtëpi të Komunitetit, asnjë hapësirë, ku fëmijët mund të kalojnë kohën e tyre, përveç SHFMU “Asdreni”, ku në shumicën e rasteve është e mbyllur për shkak të angazhimeve të tyre. Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa dhe rekomandimet janë adresuar dhe do të shqyrtohen nga drejtoritë kompetente. Për përfundimin e kanalit të Çokolicës dhe asfaltimin e rrugës përkatëse do të verifikohet dinamika e punimeve, ndërsa propozimet për shfrytëzimin e parcelave për hapësira rekreative dhe komunitare do të shqyrtohen në përputhje me nevojat e komunitetit, planifikimin hapësiror dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

26	Jakup Lajçi: Jam Kryetar i Bashkësisë Lokale “Dardania 2”. Përshëndetje për të gjithë. I kam disa kërkesa: ndriçim, kanalizim dhe asfalt. Asfaltimi i rrugës “Nurie Zeka”, 400 metra; rrugës “Valon Shala”, që e lidh “Dardaninë 2 dhe 3” dhe Loxhën e Raushiqin, ajo lidh 450 metra; në rrugën “Rexhë Avdijsa”, me gjatësi 700 metra. Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve të investimeve infrastrukturore të Komunës. Asfaltimi i rrugëve të përmendura, si dhe ndërhyrjet në ndriçim dhe kanalizim, do të planifikohen dhe realizohen në përputhje me mundësitë buxhetore dhe prioritetet e përcaktuara.
27	Granit Thaqi: Ju përshëndes të gjithëve e kam një kërkesë për rrugën “Hasan Riza”, për shkak të dëmtimit të rrugës nga ujësjellësi rruga është bërë e pakalueshme dhe kërkoj nga ju, që ta keni parasysh kërkesën dhe ta shtroni një shtresë të asfaltit.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e rehabilitimit dhe asfaltimit të segmentit të dëmtuar të rrugës, duke marrë parasysh gjendjen e saj dhe prioritetet e investimeve infrastrukturore. Realizimi do të varet nga mundësitë buxhetore dhe dinamika e punimeve përkatëse.

28	Mustafë Lajçi: Jam Kryetar i Nëndegës Rugova 1, që i përfshin 11 fshatra. Përsëendetje për të gjithë. Duke u nisur në parim, që në Bellopaq akoma nuk ka rrugë, është hapur një vijë deri në Llaz, por është ndërprerë. Në takimin, të cilin e kam bërë me Kryetarin e Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, i cili ka thënë, që do të shtrohet asfalt, por nuk po ndodh. Çka fshihet, kush ka interes, ne nuk e dimë, por jemi të diskriminuar. Pas bisedës me Drejtorin e Drejtorisë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, z.Agron Nikçin, i cili më tha që do të fillojë, por prapë asgjë. Ndërsa nuk e di kush ka interes dhe kush qëndron pas kësaj pune? Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe do të përcillet për shqyrtim te drejtoritë kompetente, me qëllim të verifikimit të statusit të projektit dhe mundësisë së vazhimit të punimeve për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës. Realizimi i projektit do të shqyrtohet në përputhje me planifikimin, procedurat dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
29	Enver Lajçi – Kërkesa për përfundimin e rrugëve dhe furnizimin me ujë.Enver Lajçi, banor i fshatit Drelaj, kërkoi:Përfundimin e asfaltimit të rrugës drejt Liqenatit, ku kanë mbetur rreth 2.5 km nga segmenti aktual, si dhe shqyrtimin e mundësisë për realizimin e rreth 6 km të tjera të rrugës; Zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë të pijshëm në Liqenat, përmes realizimit të projektit të ujësjellësit, i cili është përgatitur dhe është paraqitur më herët. Kërkesa kryesore është që projekti i furnizimit me ujë të pijshëm të përfshihet në planifikimin buxhetor, me qëllim të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm me ujë për banorët e zonës.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes në planifikimet buxhetore të projekteve për përfundimin e segmentit të mbetur të rrugës drejt Liqenatit dhe realizimin e projektit për furnizim me ujë të pijshëm. Realizimi i këtyre projekteve do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore.

30	Nezir IBERDEMAY – Kërkesa për ujësjellësin dhe infrastrukturën rrugore Nezir IBERDEMAY, Kryetar i fshatit Shtupeq i Vogël, paraqiti këto kërkesa: Përfshirjen dhe realizimin e projektit të ujësjellësit në Shtupeq të Vogël, për të cilin është siguruar pëlqimi mjedisor dhe dokumentacioni përkatës; Realizimin e unazës së fshatit, e cila ishte premtuar për vitin 2026, si dhe sqarimin lidhur me vonesat në fillimin e punimeve; Ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës nga gurra/Qeshmja drejt fshatit, me qëllim përmirësimin e qasjes dhe lidhjes rrugore me pjesët e tjera të fshatit; Përfshirjen e këtyre projekteve në planifikimin buxhetor për vitin 2027, me qëllim që edhe Shtupeqi i Vogël të ketë infrastrukturë të përshtatshme rrugore dhe furnizim të qëndrueshëm me ujë.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë përfshirjen e projekteve për ujësjellësin, unazën e fshatit dhe ndërtimin/asfaltimin e rrugës në planifikimin buxhetor për vitin 2027. Realizimi i projekteve do të bëhet në bazë të prioritetëve të Komunës, dokumentacionit teknik dhe mundësive buxhetore.
31	Xhevat Osmanaj: Jam nga Kuqishta. Përsëritet për të gjithë. E kemi dorëzuar një projekt për ndërtimin e rezervuarit, i cili ka kaluar në projekt-buxhet për vitin 2026. Kam biseduar me Kryetarin dhe Drejtorin, por nuk e di a do të bëhet këtë vit apo vitin tjetër, ku kanë ngecur punët, nuk e di? Por, Drejtori na ka premtuar, që këtë vit do të bëhet për lagjen “Gjevukaj”.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa është adresuar. Komuna do të verifikojë statusin e projektit dhe dinamikën e realizimit të tij, duke marrë parasysh se projekti është përfshirë në planifikimet buxhetore. Realizimi i projektit do të bëhet në përputhje me procedurat, planifikimin dhe mundësitë buxhetore.

32	Jusuf Lajçi: Vij nga fshati Shtupeq i Vogël, por me banim jam në rrethin e Pejës, për shkak të infrastrukturës, se s'kemi mundur ta shfrytëzojmë fshatin asnjë pikë. Është shumë e vërtetë, që fshati Shtupeq i Vogël është humnerë e madhe. Kam folur disa herë dhe deri më tani nuk është intervenuar asgjë. Pak jam i njoftuar, që ajo rruga e fshatit ka filluar diçka dhe është një ringjallje e madhe për ne. Jam në kontakt direkt me Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, por edhe me Drejtorin për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, z.Agron Nikçi. Janë premtuar gjërat dhe besoj, që këtë vit do të bëhet diçka, sepse nuk di çka të kërkoj më përpara, sepse çdo gjë është me prioritet. Sa i përket këtij viti, unë po e falënderoj këtë udhëheqësi të Pejës. Po e shoh, që kanë vendosur me vepru në Shtupeq të Vogël dhe të ndihet dora e shtetit në fshatin tonë. Në fshatin tonë ka njerëz, që merren me blegtori, që kanë dele mbi 500 copë, e kanë lopë 30 copë. Me ju thënë të vërtetën, goxha me vështirësi janë duke e mbajtur bjeshkën, sepse edhe ato rrugët ekzistuese, që janë nuk janë mirë të kalueshme. Po ashtu, kemi problem me një përrua, sepse kur ka reshje aty bëhet rruga e pakalueshme. Dhe besoj që këtë vit, na Shtupeqi i Vogël, do të jemi të kënaqur. Ju faleminderit, që më dëgjuat. Respekt për Kryetarin e fshatit, z.Nezir Iberdemaj. Respekt për punën tuaj, çka keni vepru dhe çka keni premtu.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe nevojat infrastrukture të fshatit do të trajtohen në kuadër të projekteve dhe prioriteteve të Komunës. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të rrugëve dhe zgjidhjes së problemeve të shkaktuara nga rrjedhat ujore, me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe kushteve për banorët. Realizimi do të varet nga planifikimi dhe mundësitë buxhetore.
33	Fazli Muriqi: Jam prej Rugovës, kemi vendosur për ta ngritur një shtatore të një luftëtari të Rugovës. Fjala është për Sak Faslinë. Edhe Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri është i njoftuar. Vendin na e kanë lejuar, është bërë projekti dhe shuma e projektit është 55 mijë euro. Shumën, rreth 70 për qind, e kemi mbledhur. Ne, si këshill organizativ e bëjmë një kërkesë për ndihmë, sado që mund të na ndihmoni, si Komunë lidhur me këtë projekt. Për të folur për historinë e Sak Faslisë s'ka nevojë, se figura e tij njihet. Tërë jetën e ka kaluar në luftë. Kanë shkruar gazetatat, kanë folur mediat dhe shpresoj, që do të na ndihmoni për realizimin e këtij projekti. Ju faleminderit!	Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e mbështetjes financiare për realizimin e projektit të ngritjes së shtatores, në përputhje me kriteret përkatëse, prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

34	Xhevdet Gorani: Ju përshëndes të gjithëve. Pasi, parafolësi Enveri i tha pothuajse të gjitha, po edhe unë diçka, po shtoj. Problemin kryesor e kemi me rrugë. E kanë bërë me zhavorr gati krejt, por asfalt nuk e di pse nuk e kanë bërë. Por edhe problemi me ujë. Ujë kemi pasur derisa nuk është nisur rruga. I prishën gypat. Si filluan me rregullu rrugën, janë tri burime dhe me pas mundësi me i bashku dhe ta bëjmë një pishinë të madhe dhe do të ketë ujë për të gjithë. Kaq! Ju faleminderit!	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e përfundimit të asfaltimit të rrugës dhe rregullimit të sistemit të furnizimit me ujë, duke përfshirë mundësinë e rehabilitimit dhe shfrytëzimit të burimeve ekzistuese. Realizimi i këtyre ndërhyrjeve do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
35	Qerim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë. Kam gjashtë kërkesa: Vitomirica nuk ka kanalizim, përveç një pjese shumë të vogël. Çerdhja, e cila është mbyllur për shkak të problemeve me energjinë elektrike, a do të rikthehet dhe a do të funksionojë tash e tutje? Kemi probleme me qentë endacakë në Vitomiricë, sidomos në rrugën “Sokol Nikqi”. Stacioni policor është i gatshëm dhe së shpejti pritet të lëshohet në funksion. Ndriçimi publik duhet të rritet. Rrugët tranzit në Vitomiricë janë tepër të ngarkuara dhe të dëmtuara, prandaj duhet të riasfaltohen.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e ndërhyrjeve në rrjetin e kanalizimit, përmirësimin e ndriçimit publik dhe rehabilitimin e rrugëve të dëmtuara. Çështjet që lidhen me funksionalizimin e çerdhes, qentë endacakë dhe funksionalizimin e stacionit policor do të trajtohen në bashkëpunim me institucionet kompetente. Realizimi i ndërhyrjeve do të varet nga kompetencat përkatëse, prioritetet dhe mundësitë buxhetore.

36	Safet Diplarin: Përshëndetje për të gjithë. Kam probleme me regjistrimin e shtëpisë	Pyetje, kërkesa për informim dhe sugjerime të ndryshme	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe qytetari do të udhëzohet lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e shtëpisë, në përputhje me kompetencat dhe procedurat ligjore në fuqi.
37	Naser Thaqi: Përshëndetje për të gjithë. Në një gjatësi prej 600 metrash, ujësjellësi e ka dëmtuar rrugën “Afrim Hoti” në 18 vende.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht. Komuna do të shqyrtojë mundësinë e rehabilitimit të pjesëve të dëmtuara të rrugës “Afrim Hoti”, në koordinim me institucionet dhe ndërmarrjet përkatëse. Ndërhyrjet do të realizohen në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore.

38	Meris Palamar: Përshëndetje për të gjithë. Kemi probleme me mbeturinat. Rrugët janë të mbushura me mbeturina, po ashtu edhe trotuaret. Mungon mirëmbajtja dhe duhet të largohen mbeturinat nga trotuaret.	Mallrat dhe Shërbimet	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe do të përcillet te strukturat kompetente për ndërmarrjen e masave të nevojshme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve, si dhe për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në zonat e evidentuara.
39	Dafina Draga: Përshëndetje për të gjithë. Prioritet e kemi kanalizimin, asfaltimin e rrugëve dhe rregullimin e trotuareve, si dhe riemërtimin e rrugëve.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve të Komunës. Ndërhyrjet në kanalizim, asfaltimin dhe rregullimin e rrugëve e trotuareve do të planifikohen sipas nevojave dhe mundësive buxhetore, ndërsa kërkesa për riemërtimin e rrugëve do të trajtohet sipas procedurave përkatëse.

40	Burim Mustafaj: Ndriçimi i rrugës në një gjatësi prej 600 metrash, nga trafostacioni elektrik deri te lagjja Baliçukt.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e realizimit të ndriçimit publik në segmentin e kërkuar, në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
41	Jeton Dreshaj: Ndriçimi i rrugës “Ukë Dreshaj”.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e realizimit të ndriçimit publik në rrugën “Ukë Dreshaj”, në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

42	Sefer Husaj: Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit nga lokali “Nikis Bar” deri te xhamia.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e rregullimit të trotuarit dhe përmirësimit të ndriçimit publik në segmentin e kërkuar, në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
43	Fitim Dreshaj: Rregullimi i ujërave të zeza dhe kanalizimit, si dhe vendosja e rrethojës së urës nga Nikqt deri te lagjja “Iberdemaj”.Kërkesa të tjera: Trotuari nga lokali “Nikis Bar” deri te shkolla, si dhe pastrimi i mbeturinave te varrezat e reja dhe në ledinën në fshatin Nabërgjan.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen sipas prioriteteve të Komunës. Ndërhyrjet në kanalizim, rregullimi i rrethojës së urës dhe trotuarit do të trajtohen në kuadër të projekteve infrastrukturore, ndërsa pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike do të përcillet te strukturat kompetente për trajtim. Realizimi do të varet nga mundësitë buxhetore dhe kompetencat përkatëse.

44	Imer Mujaj – Kërkesa për përmirësimin e infrastrukturës në Jabllanicë të Vogël. Imer Mujaj, në emër të Kryesisë dhe banorëve të fshatit Jabllanicë e Vogël, kërkoj: Asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave të mbetura pa asfalt, përfshirë rrugët “Isa H. Mavraj”, “Kadri Sh. Rexhaj”, “Fisnik R. Elezaj”, “Visar R. Elezaj”, “Alberim U. Mujaj”, “Esat M. Mujaj”, “Valbona Fatmir Blakaj”, “Rexhë Tahir Mujaj”, “Liridon A. Blakaj”, “Shefki M. Blakaj”, “Halit R. Mujaj” dhe “Zenun B. Mujaj”; Asfaltimin e rrugës nga qendra e fshatit drejt Varidolit, me gjatësi rreth 800 m, si dhe rrugëve të Jesenave të Epërme (800 m), Jesenave të Poshtme (300 m), Nenopolave (900 m) dhe Trojeve (2,000 m); Rregullimin e qendrës dhe sheshit të fshatit, përfshirë ndërtimin e urës mbi përrua, si dhe rregullimin e sheshit në hyrje të fshatit; Rregullimin e rrugëve fushore dhe kanaleve të ujitjes, përfshirë kanalet përgjatë shkollës, të Nenopolave, Arave të Thana, Trojeve dhe Livadheve të Shatrit; Ndërtimin dhe rregullimin e mureve mbrojtëse dhe trotuareve, veçanërisht në rrugën e Gurinave, përgjatë rrugës së fshatit dhe pranë shkollës; Vendosjen dhe përmirësimin e ndriçimit publik në rrugët sekondare të fshatit. Kërkesa është që këto prioritet të shqyrtohen dhe të përfshihen në planifikimin buxhetor, në përputhje me mundësitë dhe prioritetet e Komunës së Pejës.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen në kuadër të planifikimit buxhetor dhe prioritetëve infrastrukturorë të Komunës. Përparësi do t'u jepet ndërhyrjeve në rrugë, kanalizime dhe kanale të ujitjes, ndriçim publik, trotuare, ura dhe mure mbrojtëse, në përputhje me nevojat e evidentuara dhe mundësitë buxhetore.
45	Donjeta Bërdynaj: Përhëndetje për të gjithë në emër të lagjes “Bërdynaj” kërkojmë vazhdimin e asfaltimit të rrugës “Sahit Bërdyna” rreth 400 metra, për t'u lidhur me rrugën “Sokol Salihu”.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e vazhimit të asfaltimit të rrugës “Sahit Bërdyna”, në segmentin rreth 400 metra, me qëllim të lidhjes me rrugën “Sokol Salihu”. Realizimi i projektit do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

46	Naim Tahiri: Përshëndetje kërkesat tona për fshatin Novosellë janë: kanalizimi për ujërat e zeza, rruga Novosellë – Shtedim, Jabllanicë e Vogël, pastrami I Drinit të Bardhë nga ujërat e zeza, rregullimi I rrugës Novosellë-Dubovë e Madhe, riparimi I shtëpisë së lagjes, Mirëmbajtja e Kodrës së Dëshmorëve, varrezave, rrethojave, pra mirëmbajtja për këto hapësira.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve të Komunës. Ndërhyrjet në kanalizim, rrugë dhe pastrimin e ujërave do të trajtohen sipas nevojave të evidentuara, ndërsa mirëmbajtja e hapësirave publike, varrezave dhe objekteve të komunitetit do të përcillet te drejtoritë kompetente. Realizimi i kërkesave do të varet nga prioritetet, kompetencat dhe mundësitë buxhetore.
47	Xhevdet Ahmetaj: Përshëndetje për të gjithë kërkesat e fshatrave Lipë, Brestovikë, Cigë dhe Dushkajë janë: asfaltimi I rrugës “Sylë Hasani”, në Brestovikë 1,5 km, rregullimi I rrugës dhe Rusoli, 5 km, asfaltimi I rrugës në lagjen “Vadogjive” në Lipë 500 metra, asfaltimi I rrugës për Pllanë të Lipës 2,5 km, asfaltimi I rrugës në lagjen “Mustafaj” 200 metra, ndërtimi I rezervuarit të ujit të pijes në Vrella të Lipës dhe shpërndarja e rrjetit të ujit rezervuari 40-50 m3, rrjeti 5 km, asfaltimi I rrugës për Lipë të Vogël, Brestovikë-Lipë e Vogël, me gjatësi 5-6 km, si dhe mirëmbajtja e rrugës Lipë-Novosellë.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen në kuadër të planifikimit të investimeve kapitale të Komunës. Përparësi do t’u jepet ndërhyrjeve në asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve, si dhe sigurimit të furnizimit me ujë të pijshëm përmes ndërtimit të rezervuarit dhe zgjerimit të rrjetit. Realizimi i projekteve do të bëhet në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

48	Nexhmedin Xhuraj, nga fshati Radavc: Kërkesën e kemi për kanalizim dhe rrugën Shtedim.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohet mundësia e realizimit të projektit të kanalizimit dhe përmirësimit të rrugës Shtedim, në përputhje me prioritetet infrastrukturore dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
49	Isat Ferizaj, nga fshati Jabllanicë e Madhe: Kemi problem me ujin e pijes dhe me kanalizimin; është tmerr i madh. Kërkesë kemi edhe për rrugën për bjeshkë, si dhe te Shtëpia e Kulturës, për një fushë të volejbollit ose të basketbollit.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht dhe do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve të Komunës. Do të shqyrtohen mundësitë për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimit, rregullimin e rrugës për në bjeshkë, si dhe krijimin e një hapësire sportive pranë Shtëpisë së Kulturës. Realizimi do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

50	Nehat Bajraktari: Një ndër projektet më prioritare për rajonin tonë, po flas për Radavcin dhe Jabllanicën e Madhe, është përroi që vjen prej Jabllanicës së Madhe dhe kalon nëpër Radavc, ku po mblidhen ujërat e zeza. Vozitja nëpër fshat është duke u bërë tepër e rrezikshme. Kërkojmë dy policë të shtrirë prej betoni. Sa i përket bujqësisë në rajonin tonë, nuk ka toka për makineri të mëdha; mundësisht të sigurohen makineri të vogla, të cilat nevojiten për pemishte, dredhëza, mjedra dhe boronica.	Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat janë pranuar pjesërisht. Çështja e përroit dhe sigurisë në komunikacion do të përcillet për shqyrtim te drejtoritë kompetente, ndërsa kërkesa për sigurimin e makinerive bujqësore do të shqyrtohet në kuadër të programeve dhe mundësive për mbështetjen e bujqësisë. Realizimi i tyre do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.
51	Halil Elezaj: Çka po ndodh me sallën e edukatës fizike, kur dihet që në shtator ka me fillu mësimi? Pastaj, një gyp e kemi blerë vetë dhe e kemi vendosur me një grup vullnetarësh te përroi. Kanalizimi është i vjetruar. Shumë njerëz merren me bujqësi dhe, nëse do të kishin siguri të ujit, do të merreshin edhe më shumë. Rruga Radavc–Jabllanicë e Madhe duhet të riparohet këtë vit. Pastaj, edhe rrugët e bjeshkës, sepse do të rritej numri i njerëzve që i mbajnë kafshët, si dhe vazhdimi i trotuarit deri në Novosellë.	Projektet Kapitale + Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat e paraqitura lidhen me disa nevoja të rëndësishme të komunitetit. Për sallën e edukatës fizike dhe kanalizimin do të merren masa për adresimin e gjendjes së tyre, ndërsa rehabilitimi i rrugës Radavc–Jabllanicë e Madhe, rrugëve të bjeshkës dhe vazhdimi i trotuarit do të trajtohen në kuadër të investimeve infrastrukturore. Përmirësimi i kushteve për furnizim me ujë dhe zhvillimin e bujqësisë do të merret në konsideratë përmes programeve dhe mbështetjes për sektorin bujqësor.

52	Sylë Peli: I kemi 100 metra rrugë që duhet të asfaltohen, por pengesë kryesore është kanali i ujitjes që vjen prej Drinit deri te bazeni. Varrezat e fshatit kanë nevojë të rrethohen komplet. Ndërsa, sa i përket kërkesave të tjera, janë realizuar komplet.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Nga kërkesat e paraqitura, pjesa më e madhe e ndërhyrjeve është realizuar. Për segmentin e mbetur të rrugës, realizimi do të shqyrtohet pas zgjidhjes së çështjes së kanalit të ujitjes, ndërsa rrethimi i varrezave do të konsiderohet si nevojë për përmirësimin e infrastrukturës dhe mirëmbajtjen e hapësirës së përbashkët të fshatit.
53	Shkumbin Pelaj, nga Novosella: Problem me ujin e pijes nuk kemi. Kemi edhe një rrugë të paasfaltuar, rreth 100 metra.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për asfaltimin e segmentit të mbetur prej rreth 100 metrash është pranuar pjesërisht dhe do të merret parasysh në planifikimin e investimeve infrastrukturore për zonën. Realizimi i këtij segmenti do të varet nga prioritetet dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

54	Mijo Dakić paraqiti kërkesa që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës dhe hapësirave publike në fshatin Gorazhdec. Kërkesat e paraqitura janë: Përmirësimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik në zonat ku mungon ndriçimi ose ku ekziston nevoja për intervenime shpesh; Rregullimi i parkut dhe krijimi i një hapësire për lojëra për fëmijë, me qëllim të krijimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për rekreacion; Rrethimi i varrezave në Gorazhdec, me qëllim të rregullimit dhe mirëmbajtjes së kësaj hapësire.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat do të përfshihen në shqyrtimin e prioriteteve për Gorazhdec, me fokus në përmirësimin e ndriçimit publik dhe krijimin e hapësirave më të sigurta për komunitetin. Gjithashtu, do të vlerësohet mundësia për rregullimin e parkut dhe krijimin e këndit për fëmijë, si dhe rrethimin e varrezave, në varësi të planifikimit dhe kapaciteteve buxhetore.
55	Luka Zlatićanin paraqiti kërkesa, që lidhen me sigurinë në komunikacion dhe mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Kërkesat e paraqitura janë: Vendosija e pengesave për ngadalësimin e automjeteve, përkatësisht “policëve të shtrirë”, pranë shkollës, me qëllim të rritjes së sigurisë së nxënësve, këmbësorëve dhe banorëve; Mbështetja për sigurimin e traktorëve apo makinerisë bujqësore, me qëllim të lehtësimit të punës së fermerëve dhe zhvillimit të veprimtarisë bujqësore.	Projektet Kapitale + Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për rritjen e sigurisë pranë shkollës do të trajtohet përmes vlerësimit të mundësive për vendosjen e masave të përshtatshme të ngadalësimit të trafikut. Ndërsa propozimi për sigurimin e makinerive bujqësore do të merret në konsideratë në kuadër të programeve komunale për përkrahjen e fermerëve dhe zhvillimin e bujqësisë.

56	Dragan Vukunević paraqiti kërkesën për:Rregullimin ose ndërtimin e kanalit të ujitjes në një gjatësi prej rreth 200 metrash, duke theksuar nevojën për përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e bujqësisë	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa do të merret në konsideratë në kuadër të investimeve në infrastrukturën e ujitjes. Komuna do të vlerësojë gjendjen e kanalit dhe nevojat për ndërhyrje në segmentin e propozuar, me qëllim të përmirësimit të furnizimit me ujë për tokat bujqësore dhe krijimit të kushteve më të favorshme për fermerët.
57	Saša Petrović ngriti çështje që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe sigurinë e banorëve të lokalitetit, përkatësisht:Rregullimin dhe trajtimin e çështjes së digës, përkatësisht vlerësimin e gjendjes së saj dhe nevojës për intervenime të mundshme;Trajtimin e problemit të qenve endacakë, të cilët paraqesin shqetësim për sigurinë dhe mirëqenien e banorëve	Projektet Kapitale + Mallrat dhe Shërbimet	Adresuar	Çështja e digës do të përcillet për vlerësim teknik dhe përcaktimin e masave të nevojshme për sigurinë dhe funksionalitetin e saj. Ndërkohë, problemi me qentë endacakë do të trajtohet përmes shërbimeve dhe mekanizmave përkatës, me qëllim të rritjes së sigurisë së banorëve dhe përmirësimit të kushteve në komunitet.

58	Darko Dimitrijević paraqiti kërkesën për:Renovimin dhe rregullimin e Shtëpisë së Kulturës në Gorazhdec, me qëllim të përmirësimit të kushteve të objektit dhe krijimit të një hapësire më të përshtatshme për organizimin e aktiviteteve kulturore, sociale dhe komunitare.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa do të merret në konsideratë në kuadër të investimeve për përmirësimin e objekteve dhe hapësirave komunitare. Gjendja e Shtëpisë së Kulturës do të vlerësohet dhe, në bazë të nevojave të evidentuara, do të përcaktohen ndërhyrjet që mund të planifikohen për renovimin dhe funksionalizimin e saj, sipas mundësive buxhetore.
59	Ardita Bala: Jam nga Qendra për Mirëqenien e Gruas dhe po më vjen mire, që janë rritur subvencionet. Megjithatë, do të ishte e rëndësishme, që të ketë më shumë mbështetje edhe për gratë, e jo vetëm për sektorin e bujqësisë. Ne, të cilët ofrojmë shërbime sociale, përfitojmë nga subvencionet e Zyrës së Kryetarit. Dëshiroj të theksoj edhe një çështje, që është premtuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, që ka të bëjë me pagesën e qirasë për gratë pas daljes nga strehimi. Vetëm këtë vit, dy gra kanë përfituar pagesën e qirasë për një periudhë dyvjeçare. Megjithatë, numri i grave, të cilat kanë nevojë për këtë mbështetje, po rritet çdo ditë. Prandaj, propozoj që për vitin e ardhshëm të parashihet mbështetja për të paktën 10–20 gra për pagesën e qirasë. Ju faleminderit	Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa është pranuar pjesërisht, duke marrë parasysh nevojën për vazhdimin dhe zgjerimin e mbështetjes për gratë në situata të vështira sociale. Propozimi për përfshirjen e një numri më të madh përfitues në skemën e mbështetjes për pagesën e qirasë do të merret parasysh gjatë planifikimit të buxhetit dhe programeve për vitin 2027, në varësi të kriterëve dhe mjeteve në dispozicion.

60	Shefkije Haxhiaj: Jam Kryetare e Aktivit të Gruas Pensioniste të Pejës dhe deri më tani nuk kemi pasur asnjë lloj përkrahjeje. Kërkesa jonë kryesore është që të na sigurohet një lokal apo zyrë në qendër të qytetit, ku mund të zhvillojmë aktivitetet tona. Jemi një grup i madh grash, por për shkak të temperaturave të larta nuk kanë mundur të marrin pjesë të gjitha në këtë takim. Ne zhvillojmë vazhdimisht aktivitete të ndryshme, si joga, ushtrime aerobike dhe ecje, të cilat kontribuojnë në mirëqenien dhe shëndetin e grave pensioniste. Një hapësirë e dedikuar do të na mundësonte organizim më të mirë dhe zgjerim të aktiviteteve tona. Drejtoresha Berisha ju kthej përgjigje të gjithave me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre. Dëgjimet buxhetore janë duke vazhduar dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2027.	Projektet Kapitale	Adresuar	Kërkesa është adresuar dhe nevoja për sigurimin e një hapësire të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të grave pensioniste do të merret në konsideratë. Komuna do të vlerësojë mundësitë për sigurimin e një lokali apo hapësire komunale të përshtatshme, në përputhje me hapësirat në dispozicion dhe mundësitë buxhetore.
61	Bexhet Alimehaj: Përshëndetje për të gjithë kërkesat për planifikimin e buxhetit 2027 për fshatin Lybeniq janë: zgjerimin e ndriçimit në rrugën Himë-Lybeniq me 10 trupa ndriçimi dhe një mbi burimin e kronit të madh, përfundimin e rrugëve me asfalt, që ishin paraparë për këtë vit e që janë rruga “Dardan Alimehaj”, “Motrave Ukshinaj”, “Smail Ukshinaj” etj., ndërsa rrugët, të cilat kanë nevojë për vitin 2027 janë: zgjerimin e kanalizimit dhe lidhjen e tij me impiant apo një zgjidhje tjetër, vazhdimin e kanalit të ujitjes nga burimi Kroni i Arneshes – Zablloq me gjatësi 200 metra, kanali i ujërave të shiut, “Përroi i bletës” me gjatësi 240 metra, i cili u përmbyt këtë vit, shtëpia e fshatit muze, rruga e bjeshkës, ujësjellësi dhe tre rrath për qarkullim në fshat.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat e paraqitura do të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të prioritetëve të investimeve për vitin 2027. Fokusi do të jetë në përfundimin e projekteve të nisura dhe trajtimin e nevojave të evidentuara në ndriçim, asfaltim, kanalizim, ujësjellës, kanale të ujitjes dhe ujërave atmosferike, si dhe infrastrukturën rrugore. Projektet do të prioritetizohen në bazë të gjendjes në terren, dokumentacionit përkatës dhe mundësive buxhetore.

62	Bekim Morina: Përsëritje për të gjithë dhe në veçanti për Zyrën e Informimit Publik, të cilët bëjnë një punë jashtëzakonisht të madhe. Kërkesat tona kanë të bëjnë me shkollën e fshatit. Ne e kemi një informatë që ka me fillu vitin e ardhshëm. I kemi 1,600 metra prej Liridonit, pastaj 600 metra, rruga “Bajram Shala”, 4 metra gjerësi, që e lidh Loxhën me Raushiqin. Rruga “Valon Shala” kanë mbetur edhe 450 metra. Ndërsa, sa i përket ndriçimit, shtyllat e drurit po i rrezikojnë banorët dhe duhet të zëvendësohen. Po ia kaloj fjalën bacës Osman, se unë kërkesat do t’i paraqes me shkrim dhe kohë pas kohe do t’i adresoj edhe në Asamblenë Komunale të Pejës.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat do të merren në konsideratë në kuadër të planifikimit të investimeve për vitin 2027. Përparësi do t’u jepet përfundimit të segmenteve rrugore të evidentuara, përmirësimit të sigurisë së rrjetit të ndriçimit dhe trajtimit të nevojave infrastrukturore të shkollës. Ndërhijet do të përcaktohen sipas gjendjes në terren dhe mundësive për financim.
63	Osman Mulliqi: Ne i kemi kërkesat e njëjta që i kemi pas. Problemet me kanalizim, pastaj kemi nevojë për asfaltim të rrugëve. Është bërë një punë e mirë. Në disa rrugë brenda fshatit i kemi rreth 950 metra, i kemi të shënuara. Vazhdimin e kanaleve të ujitjes i kemi të identifikuar 4 deri në 5 kanale: një e kemi te Kastrat, një te Haxhiajt, një te shkolla, pastaj trotuaret, rrugën kryesore, pastaj shkollës me ia rregullu ndriçimin e oborrit. Të gjitha kërkesat do t’i bëj edhe në mënyrë zyrtare.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat e paraqitura do të përfshihen në shqyrtimin e prioriteteve infrastrukturore për zonën. Në veçanti, do të vlerësohen nevojat për përfundimin e asfaltimit të segmenteve të identifikuar, zgjerimin dhe përmirësimin e kanalizimit e kanaleve të ujitjes, si dhe rregullimin e trotuareve dhe ndriçimit në hapësirën e shkollës. Kërkesat e dorëzuara zyrtarisht do të trajtohen sipas procedurave dhe mundësive buxhetore.

64	Shaban Tahiraj, nga Raushiqi: Na mungojnë trotualet, ndriçimi i lagjes, ujërat e zeza, problemet me kundërmimet nga erërat. Ujë nuk kemi.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat për përmirësimin e furnizimit me ujë, zgjerimin e ndriçimit dhe rregullimin e trotuareve do të merren parasysh në planifikimin e ndërhyrjeve infrastrukturore. Problemet që lidhen me ujërat e zeza dhe kundërmimet do të trajtohen përmes evidentimit të gjendjes në terren dhe ndërhyrjeve të nevojshme në rrjetin e kanalizimit, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e Raushiqit.
65	Miftar Aliaj: E kemi një rrugë prej xhamisë së Loxhës, si dhe për varreza, e kemi paraqitur një kërkesë, si dhe për ndriçimin e fshatit.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat për përmirësimin e qasjes në rrugën nga xhamia e Loxhës drejt varrezave dhe për zgjerimin e ndriçimit publik do të merren parasysh gjatë planifikimit të investimeve për vitin 2027. Ndërhyrjet do të prioritetizohen në bazë të nevojave të komunitetit dhe mundësive për realizim brenda buxhetit komunal.

66	Shpat Kastrati: Për shkak të pamundësisë, që të jem pjesë e dëgjimeve buxhetore për fshatin Raushiq, Pejë, në cilësinë e qytetarit dhe banorit të këtij fshati, kërkoj nga ana juaj, që në kuadër të mundësive buxhetore, të realizohen këto projekte për këtë lokalitet, siç janë: Rregullimi i trotuarit në fshatin Raushiq, nga lagjja e “Çoçave” deri te dalja në rrugën kryesore, te pompa e derivateve D.H.F. Rruga në mes të fshatit Raushiq është mjaft e frekuentuar, prandaj rregullimi i trotuarit është i domosdoshëm për sigurinë e këmbësorëve, veçanërisht të fëmijëve, nxënësve dhe qytetarëve në përgjithësi. Rruga “Mark Krasniqi”, asfaltimi i rrugës Kastrat–Morinë, me qëllim të krijimit të një lidhjeje më të mirë ndërmjet fshatit Raushiq dhe fshatit Loxhë të Pejës. Vendosija e ndriçimit publik nga rruga e Kastratëve deri te stacioni i pritjes së autobusëve, te pompa e derivateve D.H.F. Arsyja e vendosjes së ndriçimit është rritja e sigurisë së qytetarëve, veçanërisht gjatë orëve të mbrëmjes dhe gjatë stinës së dimrit, si dhe shmangia e rrezikimit të fëmijëve nga qentë endacakë. Duke shpresuar se kërkesat e lartcekura do të merren në konsideratë dhe do të përfshihen në planifikimet buxhetore, ju falënderoj për mirëkuptimin dhe angazhimin tuaj.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat e paraqitura do të merren në konsideratë gjatë planifikimit të investimeve për vitin 2027. Vëmendje do t’i kushtohet përmirësimit të kushteve për këmbësorët përmes rregullimit të trotuarit, asfaltimit të segmenteve rrugore dhe zgjerimit të ndriçimit publik në pjesët ku paraqitet nevojë. Ndërhyrjet do të përcaktohen sipas rëndësisë së lokacioneve, nevojave të komunitetit dhe mjeteve të planifikuara në buxhet.
67	Ardit Gërvalla: Përsëritet për të gjithë, po i paraqes disa kërkesa, që janë prioritare për banorët e kësaj zone, duke kërkuar, që të përfshihen në Projekt-Buxhetin 2027, siç janë: Zgjerimin dhe rregullimin e plotë të lumit Behoc, nga fshati Kryshec deri në Nepole, për shkak të dëmeve të mëdha, që shkakton gjatë vërshimeve. Përfundimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në fshatin Kryshec. Lidhjen e kanalizimit të lagjes “Gërvallaj” me impiantin e trajtimit të ujërave në Kryshec, si një zgjidhje e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe eliminimin e kundërmimit të “Përroi i Gërvallës”. Asfaltimin e rrugëve, që ende kanë mbetur të paasfaltuara në fshatin Kryshec. Mirëmbajtjen e trotuareve ekzistuese nga ana e Komunës, me qëllim rritjen e sigurisë për këmbësorët. Vendosijen e pritoreve për qytetarët në të gjitha fshatrat përgjatë Lugut të Baranit, për t’u siguruar kushte dinjitoze për pritjen e transportit -	Projektet Kapitale+ Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat paraqesin nevoja të rëndësishme infrastrukturore dhe mjedisore për këtë zonë. Komuna do t’i evidentojë ato në kuadër të planifikimit për vitin 2027, me fokus në rregullimin e lumit dhe mbrojtjen nga vërshimet, trajtimin e ujërave të ndotura, përmirësimin e rrugëve dhe trotuareve, si dhe krijimin e kushteve më të sigurta për përdoruesit e transportit publik. Ndërtimi i urës në Kotradik do të vlerësohet në kuadër të projekteve infrastrukturore dhe prioriteteve të investimeve kapitale.

	autobusëve.Ndërtimin e urës në fshatin Kotradiq, një investim i domosdoshëm për lehtësimin e qarkullimit dhe lidhjen e banorëve.			
68	Agron Kelmendi: Përshëndetje për të gjithë, po vazhdoj me kërkesat e banorëve të fshatit Kosuriq, siç janë:Trotuari nga qendra e fshatit deri tek Shkolla „Migjeni“.Penda e Kratinës me kanal ujitjeje, gjatësia e tij 1,500 metra (ujitje 60 hektarë).Ura e fshatit në qendër, zgjerimi dhe ngritja e saj.Rrethojat e varrezave të fshatit.Kanali për ujitje nga Rugova deri te Maznikolli.Asfaltimi i parkingut, zgjerimi i rrugës për tek varrezat.Ndriçimi i fshatit.Vazhdimi i kanalit prej qendrës deri tek ura e Adem Kadrisë.Riemërtimi i rrugës Tuljezhit në „Tre Dëshmorët“.Kanali për ujitje të Ali Gashit nga ish-drejtori i shkollës.Ngritja e kanalit tek Rugova dhe zgjerimi i rrugës aty.Asfaltimi i rrugës tek Zenel Kelmendi dhe në qendër të fshatit.Hapësira për këndin e lojërave afër shtëpisë së fshatit.Kanali i ujitjes në Serisht, gjatësi 300 metra.Menaxhimi i mbeturinave, mos hyrja e mbledhjes në qendër në drejtim të varrezave.	Projektet Kapitale+ Mallrat dhe Shërbimet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat e banorëve do të merren në konsideratë në përcaktimin e prioriteteve për vitin 2027. Fokusi do të jetë në përmirësimin e qasjes dhe sigurisë përmes rrugëve, urës, trotuareve dhe ndriçimit, si dhe në zhvillimin e infrastrukturës së ujitjes për tokat bujqësore. Rregullimi i varrezave dhe krijimi i hapësirës për fëmijë do të vlerësohen si pjesë e hapësirave komunitare, ndërsa çështja e mbledhjes së mbeturinave do të trajtohet në kuadër të shërbimeve komunale. Kërkesa për riemërtimin e rrugës do të procedohet sipas rregullave përkatëse.

69	Metush Krasniqi: Në Kryshec kemi nevojë për një shtëpi pritjeje. Te Kryetari Muhaxheri kam qenë dhe më ka thënë se besoj që do të veprojmë. Pastaj kemi nevojë për 750 metra asfaltim para një kulle, e cila është kullë e moçme, si dhe asfaltimin e hyrjes. Të gjitha kërkesat do t'i sjell në komunë me shkrim.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat do të merren në konsideratë në kuadër të planifikimit të investimeve për Kryshec. Nevoja për një shtëpi pritjeje do të vlerësohet si hapësirë me rëndësi për komunitetin, ndërsa asfaltimi i segmentit prej rreth 750 metrash dhe rregullimi i hyrjes do të shqyrtohen sipas gjendjes së infrastrukturës dhe prioriteteve të investimeve. Kërkesat e dorëzuara zyrtarisht do të trajtohen në përputhje me procedurat dhe mundësitë buxhetore.
70	Mark Kabashi, përfaqësues i fshatit Gllogjan: E kemi problem zgjerimin e prrojeve. Një reshje më e vogël, menjëherë po del prej shtratit dhe ka kaluar në këtë rrugën, që është ndërtuar tash, Gllogjan-Llugaxhi, që nuk po dihet a është asfalt apo lumë. Mirëmbajtjen e rrugëve e kemi problem. Rruga, që është ngushtuar shumë, rruga Gllogjan-Vokshiq, edhe rruga Gllogjan-Llugaxhi, ku është e nevojshme edhe hapja e atyre kanaleve, që të mos dalë uji dhe të dëmtojë asfaltin. Por kemi nevojë edhe për mirëmbajtjen e mexhave, se mezi po përballen makinat mes vete. Edhe një kërkesë e veçantë është se shumë vite e kemi bërë kërkesën për kanal të ujitjes, mbi 100 hektarë, që janë të nevojshëm për t'u ujitur, por ujiten në mënyrë primitive.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat do të trajtohen sipas nevojave më të theksuara të komunitetit. Vëmendje do t'i kushtohet zgjerimit dhe pastrimit të kanaleve për menaxhimin e ujërave atmosferike, si dhe mirëmbajtjes së rrugëve Gllogjan-Llugaxhi dhe Gllogjan-Vokshiq, me qëllim të parandalimit të dëmtimeve dhe rritjes së sigurisë në qarkullim. Gjithashtu, nevoja për kanal të ujitjes për sipërfaqet bujqësore do të merret në konsideratë në planifikimin e investimeve për bujqësi dhe ujitje.

71	Demë Gashi, kryetar i Bashkësisë Lokale të Baranit: Mua më së shumti më intereson çështja e ujësjellësit?	Projektet Kapitale	Adresuar	Çështja e furnizimit me ujë të pijshëm në Baran do të përcillet për trajtim te strukturat dhe institucionet përgjegjëse, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së rrjetit dhe nevojave për ndërhyrje. Në bazë të vlerësimit do të përcaktohen hapat e mëtejshëm për përmirësimin e furnizimit me ujë.
72	Atdhe Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket bujqësisë, furnizimi me mekanizëm bujqësor dhe pajisje të tjera përcjellëse është në rregull, ndërsa këto të tjerat jo mirë të realizuara. Për shembull, rrethojat e fshatit Çallapek rezultojnë me defekte të jashtëzakonshme. Kërkesë e kemi vazhdimin e ndërtimit të kanaleve të ujitjes, ndërtimin e tri pendave, zgjerimin e ndriçimit, por na ka mbetur një pjesë në lagjen “Kamenicë”. Ndërtimi i tri pendave dhe urave, hapja e shtretërve të lumenjve, vitalizimi i kanalit të ujitjes në lagjen “Kamenicë”. Varrezat e fshatit Çallapek, të lagjes “Kamenicë”, ndodhen në një pjesë të shpatit. E kemi diskutuar herën e fundit që të bëhet, janë rreth 200 metra, të ketë një mur mbrojtës. Po ashtu, e kemi një lagje brenda lagjes “Kamenicë”, ndërmjet shtëpive, ku na duhet të ndërtohet një rrugë.	Projektet Kapitale + Subvencionet dhe Transferet	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat e paraqitura do të merren në konsideratë në kuadër të prioritetëve për zhvillimin e infrastrukturës dhe bujqësisë. Do të vlerësohen nevojat për vazhdimin e kanaleve të ujitjes, ndërtimin e pendave dhe urave, zgjerimin e ndriçimit, hapjen dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve, si dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e varrezave dhe përmirësimin e qasjes rrugore në zonat e evidentuara. Mbështetja në bujqësi do të vazhdojë sipas programeve dhe kriterëve përkatëse.

73	Veton Dervishaj, përfaqësues i fshatit Kotradiq: Kemi nevojë për pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe digës, ndërtimin e urës mbi lumin Bistrica e Deçanit, e cila lidh mbi 50 hektarë toka bujqësore. Çka është me rëndësi këtu, e kemi të ndarë edhe një parcelë, që e kemi caktuar për varreza dhe kemi nevojë shumë të madhe, që të jetë kjo urë dhe të kemi qasje për ta shfrytëzuar atë parcelë për këtë qëllim. Pastaj, nuk kemi rrjet të kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në kanalet përgjatë fshatit.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesat do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve infrastrukturorë për Kotradiq. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pastrimit dhe funksionalizimit të kanaleve të ujitjes, si dhe mundësisë për ndërtimin e urës mbi lumin Bistrica e Deçanit, e cila do të përmirësonte qasjen në tokat bujqësore dhe në parcelën e destinuar për varreza. Gjithashtu, mungesa e rrjetit të kanalizimit do të evidentohet për trajtim dhe përcaktimin e një zgjidhjeje të përshtatshme për menaxhimin e ujërave të zeza.
74	Driton Gashi, përfaqësues i fshatit Buqan: Na kemi problem me reshjet atmosferike dhe rrezikohen banorët dhe shtëpitë afër. Rreth 60 metra na duhen. Pastaj, rruga Buqan-Kamenicë, që e lidh Baranin, dhe disa rrugica të fshatit.	Projektet Kapitale	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Kërkesa për trajtimin e problemit të ujërave atmosferike në segmentin prej rreth 60 metrash do të merret në konsideratë, me qëllim të mbrojtjes së banorëve dhe pronave nga përmytjet. Gjithashtu, nevojat për përmirësimin e rrugës Buqan–Kamenicë dhe të rrugicave të fshatit do të evidentohen dhe do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve të investimeve infrastrukturorë për vitin 2027.

75	Selman Krasniqi: Rruga kryesore nuk mirëmbahet dhe është kompetencë e Qeverisë. A ka kush që merret me këtë çështje dhe të dimë ne se dikush e ka tenderin, por nuk interesohet për mirëmbajtjen e rrugës?	Adresuar	Pjesërisht e pranuar / Aprovuar	Çështja e mirëmbajtjes së rrugës kryesore, e cila është në kompetencë të nivelit qendror, do t'i përcillet institucionit përgjegjës për shqyrtim dhe marrjen e masave të nevojshme. Komuna do të kërkojë informacion lidhur me përgjegjësinë dhe kontratën për mirëmbajtjen e kësaj rruge, në mënyrë që banorët të kenë një pasqyrë më të qartë për trajtimin e saj.
----	--	----------	--	---

5. KONKLuzionet dhe Hapat e mëtejshëm

Procesi i hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027, i shoqëruar me planifikimet orientuese për vitet pasuese në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, është zhvilluar në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Në kuadër të këtij procesi janë organizuar konsultimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 dhe dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e vitit 2027, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, këshillave të fshatrave dhe bashkësive lokale, organizatave të grave, klubeve sportive, të rinjve dhe grupeve të tjera të interesit.

Gjatë këtyre konsultimeve janë paraqitur propozime dhe rekomandime të shumta, të cilat pasqyrojnë nevojat dhe prioritetet zhvillimore të qytetarëve. Kërkesat janë fokusuar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndriçimin publik, zhvillimin e infrastrukturës arsimore dhe sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve komunitare, si dhe mbështetjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, rinisë dhe sportit.

Të gjitha kërkesat e pranura gjatë procesit të konsultimeve publike janë shqyrtuar nga Grupi Punues në bashkëpunim me drejtoritë komunale përkatëse dhe janë vlerësuar në përputhje me kompetencat ligjore të komunës, prioritetet strategjike dhe mundësitë buxhetore.

Pas përfundimit të procesit të konsultimeve publike, Komuna e Pejës do të vazhdojë procedurat për finalizimin e Projekt-Buxhetit të vitit 2027 dhe procedimin e tij për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal, në pajtim me afatet e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Në këtë kuadër, hapat e mëtejshëm përfshijnë:

- Analizimin dhe sistematizimin e të gjitha kërkesave, komenteve dhe rekomandimeve të pranura gjatë konsultimeve publike;
- Harmonizimin e kërkesave me prioritetet zhvillimore të Komunës së Pejës dhe mundësitë buxhetore;
- Përgatitjen e versionit përfundimtar të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027;
- Procedimin e Projekt-Buxhetit për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal, në përputhje me afatet ligjore;
- Publikimin e dokumenteve përfundimtare dhe informimin e qytetarëve mbi rezultatet e procesit të konsultimeve publike;
- Vazhdimin e praktikave të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare gjatë zbatimit të buxhetit.

Komuna e Pejës mbetet e përkushtuar për një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm të planifikimit buxhetor, duke siguruar që prioritetet e qytetarëve të trajtohen në përputhje me interesin publik, mundësitë financiare dhe objektivat strategjike të zhvillimit lokal.

6. AFATET KOHORE

Përgatitja e Raportit

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, raporti për rezultatet e konsultimeve publike përgatitet brenda afatit prej së paku pesëmbëdhjetë (15) ditësh dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e komenteve, propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.

Publikimi i Raportit

Brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga përfundimi i raportit nga Grupi Punues, raporti i dorëzohet zyrtarit përgjegjës për konsultime publike, i cili siguron publikimin e tij në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës dhe në platformën elektronike për konsultime publike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

7. ANEKSET

Raportit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Aneksi 1 - Njoftimi për konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029;
- Aneksi 2 - Njoftimi dhe Kalendari i Dëgjimeve Publike për Projekt-Buxhetin e vitit 2027;
- Aneksi 3 - Procesverbalet e konsultimeve publike;
- Aneksi 4 - Listat e pjesëmarrësve;
- Aneksi 5 - Materialet prezantuese të Projekt-Buxhetit;
- Aneksi 6 - Tabela e detajuar e kërkesave dhe statusit të tyre;
- Aneksi 7 - Fotografitë nga dëgjimet publike, të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës dhe të qasshme përmes lidhjes: <https://peja.rks-gov.net/lajmet-2/>



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA




KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Pejë, datë: 25/08/2026

Nr. Protokollit: 01-060/01-64603

Për	Rexhep Kurtbogaj - Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës
Cc	Gazmend Muhaxheri - Kryetar i Komunës së Pejës
Nga	Grupi Punues
Lënda	Raporti Përmbledhës për organizimin e konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027. Procesi konsultativ ka përfshirë konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029, si dhe dëgjimet buxhetore me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit, me qëllim identifikimin dhe trajtimin e prioriteteve dhe kërkesave të komunitetit gjatë hartimit të Projekt-Buxhetit. Procesi është zhvilluar duke siguruar transparencë, llogaridhënie, pjesëmarrje qytetare dhe respektim të legjislacionit në fuqi dhe parimeve të qeverisjes së mirë.



KOMUNA E PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Nr. Protokolit: 01-016-01-65079

Data: 01.09.2026

NJOFTIM

Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, Neni 61, paragrafi 61.2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjigjësitë, Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës, si dhe në bazë të neni 22 pika 1.4. të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratën e Hapur në Komunë, Kuvendi i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik organizon:

Konsultim Publik

për

Projekt-buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027-2029

Qytetarë të nderuar të Komunës së Pejës, ju njoftojmë që të merrni pjesë në **Konsultimin Publik** për: **Projekt-buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027-2029**. Ky Konsultim publik, organizohet nga Kuvendi i Komunës së Pejës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra për Informim Publik.

Konsultimi Publik do të mbahet me dt. **16.09.2026 (Mërkure)**, ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Pejës.

Njoftimin dhe Projekt-buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027-2029 mund ta gjeni të publikuar në web-faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me 15.09.2026 në emailat: dielleza.berisha@rks-gov.net, Hajrije.Haxhijaj@rks-gov.net, gazmend.turku@rks-gov.net, rexhep.kurtbogaj@rks-gov.net, Avni.C.Gashi@rks-gov.net, Ariana.Lukaj@rks-gov.net dhe Arianit.Demaj@rks-gov.net.



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ
Br. Protokola: 01-016-01-65079

Datum: 01.09.2026

OBAVEŠTENJE

Na osnovu člana 68 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Kosova Br.03/L-040, člana 61.2 Zakona br. 03/L-040 o Upravljanju Javnim Finansijama i Odgovornostima, Statuta br. 01-2020 Opštine Peć, kao i na osnovu člana 22 tačka 1.4 Administrativnog Uputstva MALV-a o otvorenoj administraciji u opštinama, Skupština Opštine Peć u saradnji sa Direktoratom za Budžet i Finansije i Kancelarijom za Javno Informisanje organizuje:

Javnu raspravu

o

o nacrtu budžeta opštine Peć za period od 2027-2029godine

Poštovani građani Opštine Peć, pozivamo vas da učestvujete na **javnoj raspravi o o nacrtu budžeta opštine Peć za period od 2027-2029 godine**. Ovu javnu raspravu organizuje Skupština Opštine Peć, Direktor za Budžet i Finansije i Kancelarija za Javno Informisanje.

Javna rasprava će biti održana **16.09.2026** (srijeda) u 11:00 časova u Sali Skupštine Opštine Peć. Pravo na učešće imaju svi građani Opštine Peć.

Obaveštenje i nacrt budžeta Opštine Peć za 2027-2029 godinu možete pronaći na web stranici Opštine Peć.


Vaše komentare i sugestije možete poslati do 15.09.2026. godine na e-mail adrese: dielleza.berisha@rks-gov.net, Hajrije.Haxhijaj@rks-gov.net, egzon.kastrat@rks-gov.net, rexhep.kurtbogaj@rks-gov.net, Avni.C.Gashi@rks-gov.net, Ariana.Lukaj@rks-gov.net dhe Arianit.Demaj@rks-gov.net.



PREDSIEDAVAJUĆI SKUPŠTINE

G. Rexhep Kurtbogaj

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433



DREJTORATI KOMUNAL I ARSIMIT



DATE/A:	02.09.2026
REFERENC-Ë:	634/31
PËR/ZA/TO:	Kryesusi i kuvendit Z. Rexhep Kurtbogaj
NGA/OD/FROM: DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit-Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për flimin e vitit shkollor 2026/2027 në shkollat e Komunës së Pejës

Drejtoria Komunale e Arsimit , në kuadër të përgjegjësiave dhe kompetencave të saj , ka ndërruar të gjitha veprimet e nevojshme për përgatitjen e institucioneve arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/27.

Përgatitjet janë realizuar në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve arsimore, me qëllim që procesi mësimor të fillojë në mënyrë të rregullt , të sigurt dhe në përputhje me planifikimet dhe udhëzimet përkatëse.

Në kuadër të këtyre përgatitjeve janë realizuar:

- Planifikimi i organizimit të procesit mësimor
- Përgatitja e orarave mësimore
- Angazhimi dhe sistemimi i mësimdhënësve
- Përgatitja dhe mirëmbajtja e hapësirave shkollore
- Informimi i nxënësve dhe prindërve për organizimin e fillimit të vitit shkollor

Në bazë të informacioneve të pranuar nga shkollat ,përgatitjet janë realizuar me kohë dhe shkollat kanë qenë të gatshme për pritjen e nxënësve në ditën e parë të mësimi.

Viti i ri shkollor 2026/27 ka filluar në mënyrë të rregullt në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Pejës ,përveç në paralelen e ndarë Dardania 3 ,të ShFMU”Pjetër Budi “ në Poqestë , ku fillimi i mësimi për shkak të punimeve që po realizohen është shtyrë për një javë.

Sipas të dhënave nga institucionet arsimore , në vitin shkollorë 2026/27 janë janë regjistruar:

- në nivelin fillor (klasa e parë) 1100 nxënës

- në klasën e dhjetë 1114 nxënës

Të dhënat për numrin e nxënësve janë evidentuar dhe janë në proces të verifikimit dhe përditësimit në Sistemin e Menaxhimit të Informativ të Arsimit –SMIA.

-Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor, janë realizuar dhe inicuar punë dhe investime me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe funksionale në institucionet arsimore.

Punët e realizuar dhe ato në proces përfshijnë:

- është realizuar renovimi dhe ndërtimi i drenazhës në ShFMU”Vaso Pashë Shkodrani” dhe ShFMU”Haxhi Zeka”
- kanë përfunduar punimet në renovimin dhe ndërtimin e kulmit të palestrës /sallës së sportit në ShFMU”Lidhja e Pejës” Novosellë.
- janë në proces punimet rreth renovimit dhe ndërtimit të strehës së sallës në ShFMU”lidhja e Prizrenit”
- është në proces të prokurimit renovimi dhe shtrimi i parketit në sallat e sportit në ShFMU”Lidhja e Pejës” dhe në IAAP”Rifat Gjota”

Gjithashtu, janë nënshkruar kontratat për furnizimin dhe mirëmbajtjen me material të nevojshme për institucionet arsimore, përfshirë:

- Materialet didaktike për nevojat e përgjithshme të shkollave
- Materialet elektrike
- Materialet sanitare
- Është në fuqi kontrata për lëndë djegëse (pelet) nga viti i kaluar
- Kontrata për sigurimin e lëndës djegëse –drunore është në përfundim

Bazuar në raportimet e institucioneve arsimore ,të dhënat e mbledhura dhe monitorimin e realizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit , konstatohet se viti i ri shkollor 2026/27 ka filluar me kohë dhe në mënyrë të rregullt në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Pejës .



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	DL
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	1
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	3747-2/20
Data. Datum. Date.	15.07.2026
PRISHTINË/A	

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH VL 130/26 Date: 14.07.2026
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	i Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	i Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimit Nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023-2031

I nderuar kryetar Muhaxheri,
I nderuar kryesues Kurtbogaj

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 05.05.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendimin Nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023-2031**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal së Pejës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimit Nr.24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2023-2031

ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

